

Dr. Izber HOTI

KOSOVA DHE VISET E TJERA ETNIKE SHQIPTARE NGA KAPITULLIMI I ITALISË FASHISTE DERI NË FUND TË NËNTORIT 1944

Çarmatimi i forcave italiane dhe vendosja e pushtetit gjerman

Pas çarmatimit të forcave pushtuese italiane, që u bë me marrëveshjen e gjermanëve dhe të italianëve të 10.IX.1943, një pjesë e forcave italiane iu bashkëngjit pushtuesve gjermanë, ndërsa pjesa tjetër LNÇ-së në Kosovë. Njësitet e divizionit italian “Puglie” i çarmatosi Korparmata e 21-të gjermane.

Si në Shqipëri, ashtu edhe në Kosovë Gjermania naziste u deklarua se ishte mike e shqiptarëve dhe se armiku i tyre ishin komunistët dhe BRSS. Për demagogji në këtë kohë iu kushtua kujdes i madh shpalljes së “pavarësisë” së Shqipërisë, në kuadrin e së cilës natyrisht bënte pjesë edhe Kosova dhe disa vise të tjera etnike shqiptare. Forcat shqiptare që miratuan pushtimin gjerman shënjestrën e tyre e drejtuan në propagandimin e politikës së mbrojtjes së kufijve shqiptarë, ndërsa nga pjesëtarët dhe përkrahësit e LNÇ-së kërkonin të hiqnin dorë nga rruga e Titos. Si pasojë në Kuvendin Popullor të Shqipërisë, të organizuar më 16 – 23.X.1943, në Tiranë dhe në qeverinë që u shpall pas këtij kuvendi u përfshinë një pjesë e konsiderueshme e shqiptarëve nga Kosova dhe nga viset e tjera etnike shqiptare, ndërsa kryetar i kësaj qeverie, të formuar më 4.XI.1943, u emërua Rexhep Mitrovica. Në këtë frymë pas kapitullimit të Italisë fashiste nuk u bënë ndryshime në ndarjen administrative dhe as në dikasteret ekzistuese, veç shtimit të Komitetit të Lidhjes së Dytë të Prizrenit dhe të ndonjë force të re të armatosur në ndërkohë, siç ishte p.sh. Feldkomandatura 1035 në Prizren, që kujdesej për sektorin e prapavijës, si dhe një feldkomandaturë në Strugë. Viset e pushtuara shqiptare nga Bullgaria fashiste, si dhe territori i Mitrovicës mbetën në gjendjen e mëparshme, ndërsa në shtator të vitit 1944,

kur Bullgaria fashiste kapitulloi, territoret nga afërsia e Shkupit dhe ato në vijën Kumanovë – Preshevë – Bujanoc filluan të kontrolloheshin nga përkrahësit shqiptarë të pushtuesve gjermanë, veçanërisht forcat e armatosura vullnetare. Të kota mbetën edhe përpjekjet e profashistëve bullgarë që donin t'i aneksonin Bullgarisë, Tetovën, Gostivarin, Kërçovën, Dibrën, Strugën etj. Të kota mbetën edhe përpjekjet e qarqeve drejtuese shqiptare që gjermanët të rishikonin qëndrimin e tyre për të ashtuquajturin qark i Kosovës, i cili edhe më tej mbeti nën sundimin e qeverisë së Nediqit. Për këtë qëllim më 10. V. 1944 në krajskomandaturën e Mitrovicës u mbajt një takim me përfaqësuesit e Lidhjes Popullore Shqiptare, në të cilin mori pjesë Xhafer Deva në cilësinë e ministrit të Punëve të Brendshme të Shqipërisë. Me atë rast u kërkuar që qarku i Kosovës, pa rrethin e Studenicës, t'i bashkohej Shqipërisë. Xhafer Deva pasi mori pëlqimin e tubimit, udhëtoi për në Berlin, ku u takua personalisht me Hitlerin, i cili me sa duket i premtoi se do të kishte parasysh kërkesat e shqiptarëve.

Divizioni i 21-të SS malor “Skenderbeg”

Sigurimi i Kosovës, Maqedonisë Perëndimore dhe i një pjese të Malit të Zi iu besua edhe Divizionit të 21-të SS malor “Skenderbeg”, sepse në kohën e formimit të tij në Kosovë ekzistonte vetëm një batalion i Ushtrisë Shqiptare, ndërsa për shkak të rrethanave për sigurimin e Kosovës këto dhe forcat e milicisë e të xhandarmërisë nuk mjaftonin. Për formimin e këtij divizioni u angazhua edhe qeveria shqiptare, por edhe Lidhja e Dytë e Prizrenit, veçanërisht kryetari i komitetit të kësaj lidhjeje, Bedri Peja. Pushtuesit gjermanë me përkrahësit e tyre shpresonin se do të mobilizonin afro 50.000 njerëz, mirëpo rekrutët nuk iu përgjigjen thirrjes ashtu siç mendohej. Deri më 25. IX. 1944 u rekrutuan 11.398 vetë, ndër të cilët ishin të aftë 9.275, kurse në ushtri hynë vetëm 6.491 vetë. Edhe dezertimet nga ky divizion ishin të ndjeshme, prandaj së shpjeti ai u riorganizua dhe si i tillë dhe sa ekzistoi luftoi kundër UNÇJ-së në Kosovë, në Maqedoninë Perëndimore dhe në Mal të Zi.

Rrethanat ekonomike dhe arsimore

Vendosja e pushtetit nazist gjerman nuk ndikoi në përmirësimin e gjendjes së përgjithshme në Kosovë dhe në viset e tjera etnike shqiptare. Premtimet e qeveritarëve shqiptarë për një reformë agrare mbetën të kota. Për shkak të rrjedhave të luftës u rritën çmimet e prodhimeve bujqësore,

ndërsa tregtarët bënëin spekulim edhe me prodhime të tjera. Sigurimi material i ushtrisë gjermane, nga ana tjetër, ndikoi në çështjen financiare dhe në rënien e valutës shqiptare. Pushtuesit gjermanë edhe sipas marrëveshjes me autoritetet shqiptare dhe ligjit të miratuar më 1944 gëzonte të drejtë të pakufizuar të shfrytëzimit të xeheve në Kosovë. Për këtë arsye në vitin 1944 në “Trepçë” u përpunuan 272.031 tonë xehe (prej tyre 24.160 tonë koncentrat plumbi dhe 10.952 tonë koncentrat zingu), si dhe 26.477 kg argjend të përpunuar dhe 8.760 kg pirit, por edhe xehe të tjera, që për kohën ishin të konsiderueshme. Megjithatë, ky shfrytëzim krahasuar me periudhën 1941 – 1943 ishte shumë më i vogël.

Nga rrethanat ekonomike dhe nga rrjedhat e luftës varej edhe arsimi. Qeveria shqiptare autorizoi Ministrinë e Arsimit që të lëshojë një qarkore në të cilën shkruhej se shkolla ishte shndërruar në vatër komunistësh dhe kërkohesh prej arsimtarëve që të bënin çmos që ajo të bëhej burim i nacionalizmit dhe i bashkimit shqiptar, duke shkatërruar të gjitha ndikimet komuniste. Për këtë arsye u formuan edhe komisione të veçanta, të cilat kishin për detyrë të punonin në ndryshimin e plan–programeve dhe teksteve shkollore, në mënyrë që të mënjanoreshin të gjitha ndikimet e dhunshme nga fashistët italianë, kurse në qarkun e Mitrovicës politika arsimore kishte mbetur e njëjtë sikurse në periudhën 1941-1943.

Shtypja, terrori dhe raprezaliet

Pas kapitullimit të Italisë fashiste rrjedha e zhvillimit të LNÇ-së në Kosovë dhe në viset e tjera etnike shqiptare u përmirësua ndjeshëm. Në këtë frymë ndikuan sukseset e aleatëve kundërnazifashistë në botë, si dhe përhapja dhe zhvillimi i LANÇ-së në Shqipëri dhe në Jugosllavi. Megjithatë, gjendja edhe më tej ishte shumë e ndërlikuar. Veç forcave gjermane dhe forcave shqiptare, që ishin bashkëpunëtorë të tyre, Xhafer Deva arriti të formojë edhe Regjimentin e Kosovës të përbërë prej 1.500 xhandarësh me komandant Pajazit Boletin. Regjimenti kishte për detyrë të vinte “rend e qetësi” si në Kosovë ashtu edhe në Shqipëri. Ai u dallua për rreptësinë e tij kundër pjesëtarëve dhe përkrahësve të LNÇ-së, veçanërisht kundër serbëve dhe malazezve. Vetëm në Pejë ai vrau 39 vetë, shumica serbë e malazezë. Kështu veproi më 4.II.1944 në Tiranë, ku vrau 84 njerëz. Terror të ndjeshëm në fund të vitit 1943 dhe në fillim të atij 1944 organizuan edhe forca të tjera pushtuese dhe bashkëpunëtorët e tyre, kur u bë edhe shpërngulja e ndjeshme e serbëve dhe malazezve nga Kosova. Prej vitit 1941 deri më 25.IV.1944 nga Kosova u shpërngulën 40.000 serbë, ndërsa planifikohej të shpërnguleshin edhe 30.000 të tjerë. Nga Divizioni i 21-të SS malor

“Skenderbeg” prej 25.V.1944 deri më 5.VII.1944 u arrestuan 510 hebrenj, prej tyre 249 u deportuan në kampet e përqendrimit në Gjermani. Po kështu, në kampin e formuar të përqendrimit në Prishtinë prej 19.IX.1944 deri më 23.X.1944 u pushkatuan 131 pjesëtarë të LNÇ-së dhe komunistë shqiptarë. Vetëm më 23.X.1944 në këtë kamp u pushkatuan 105 komunistë të Shqipërisë. Në fillim të vitit 1943 në burgun e Mitrovçës u vranë 360 pjesëtarë e përkrahës serbë të PKJ-së e të LNÇ-së. Popullsia terrorizohej edhe nga ana e pushtetit bullgar. Në dhjetor të vitit 1943 ata deportuan një grup të madh shqiptarësh në Bullgari për të punuar në meremetimin e rrugëve. Shqiptarët në këtë rajon terrorizoheshin edhe nga çetnikët dhe serbët vendës. Më 17.IX.1943 çetnikët në xhaminë e Preshevës hodhën bombë në kohën kur faleshin teravitë. Me atë rast u vranë tre dhe u plagosën 32 shqiptarë.

Përleshjet shqiptaro – serbo – malazeze

Në kohën e kapitullimit të Italisë fashiste vazhduan sulmet çetnike në drejtim të Plavës dhe të Gucisë. Më 8.IX.1943 forcat shqiptare dhe çetnike u përleshën në fshatin Cecun afër Andrijeviçës, kurse më 12 të po këtij muaji këto forca iu afruan Murinës. Duke parë vendosmërinë e shqiptarëve për të mbrojtur atë, çetnikët kërkuar bisedime të cilat u zhvilluan më 23 dhe 24.IX.1943 dhe më e keqja u evitua. Megjithatë, rreziku ishte i pranishëm, prandaj, edhe përkundër formimit të Lidhjes së Dytë të Prizrenit, duhej vazhduar mbrojtja vullnetare e kufirit në drejtim të Malit të Zi e të Serbisë. Për mbrojtjen e kufirit me Malin e Zi u dalluan Shemso Ferri, Shaban bej Rexhepagiqi e Hajro Shahmani, ndërsa për atë në drejtim të Serbisë Pajazit e Adem Boletini, Mehmet Gradica, Salih Kolludra–Gashi, Bislim Bajgora, si dhe Xhelal Mitrovica, Fuad Dibra, Qazim Komoni, Rexhep Gjilani, Sylejman Shkoza–Vuçiterna, Hysni Rudi, Shefqet Bylykbashi, Sabit Basha, Nazmi Budriga, Demir Korça, Gjini Martini etj. Përpjekjet e forcave vullnetare të Plavës dhe të Gucisë nën komandën e Shemso Ferrit që të bashkëpunonin me partizanët shqiptarë nuk u kurorëzuan me sukses. Në këto rrethana forcat vullnetare shqiptare ishin të detyruara të angazhoheshin në luftime kundër forcave çetnike, por edhe atyre partizane, kur bashkëpunonin në sulmet kundër trevave shqiptare. Forcat e shumta çetnike në nëntor të vitit 1943 u përpoqën të depërtonin në trevat shqiptare të Sanxhakut. Mbrojtësve të Pazarit të Ri u erdhën në ndihmë vullnetarët nga ana e Mitrovicës, Podgurit, Anadrinisë, Rugovës dhe Llapit. Luftimet filluan pas ultimatumit të Kostë Peçancit që forcat shqiptare të largoheshin nga kufiri brenda 14 orësh. Ato zgjatën prej 17 deri më 20.XI.1943 dhe forcat

çetniko-partizane patën 190 të vrarë e mbi 90 të plagosur, ndërsa shqiptarët 75 të vrarë dhe 145 të plagosur. Përleshjet shqiptaro-serbe vazhduan edhe gjatë vitit 1944. Më 2.II.1944 forcat çetnike sulmuan njësitet e vullnetarëve në zonat kufitare në fshatrat Tebelie, Vitkovicë etj. Gjatë këtyre luftimeve u vranë e u plagosën 58 vullnetarë, ndërsa njësitet e mbetura u tërhoqën në pozicione të sigurta. Më 8.II.1944 në sulmin që çetnikët organizuan kundër fshatrave Banjë dhe Pridvoricë në afërsi të Mitrovicës shqiptarët patën 70 të vrarë dhe mjaft të plagosur. Për t'u ndihmuar u nis komandanti i garnizonit të Tutinit, Aqif Blyta, i cili në marrëveshje me prefektin e këtij vendi bëri thirrje të cilës iu përgjigjën burrat e Tërnavës, Vojkoviqit e të Pazarit të Ri dhe në këtë mënyrë u ndalua sulmi i çetnikëve. Në gjysmën e shkurtit të vitit 1944 prefekti i Mitrovicës kërkoi nga KQ i Lidhjes së Dytë të Prizrenit të dërgonte në ato rajone vullnetarë nga Drenica dhe Podguri. Nga nënprefektura e Istogut, falë angazhimit të Isuf Boletinit, kryetar i komunës së Rakoshit, u mobilizuan 400 vullnetarë, të cilëve u ndihmoi njësi i artilerisë i komanduar nga kapiten Hysni Rudi. Luftimet në frontin e Kolashinit nisën më 15.II.1944 me përleshjet në fshatrat Rezallë e Çiçevë, ndërsa mësyemja e përgjithshme u bë më 17 të këtij muaji. Çetnikët u detyruan të tërhiqen. Më 25 shkurt forcat shqiptare morën fshatrat Dragaçevë, Grubetiç dhe Hot, si dhe 32 fshatra të komunës së Kolashinit, duke e pastruar rajonin nga çetnikët. Këto veprime u kryen nën komandën e Qazim Komonit, komandant i Sektorit Kosova të Ushtrisë Shqiptare, ndërsa kontribut të veçantë dhanë Lush Gega dhe Qerim Gjoci, duke përdorur me mjeshtri topin e tyre. As këto veprime dhe as goditja politike që iu bë në arenën ndërkombëtare çetnikëve nuk ua ndali hovin. Më 23.V.1944 disa njësite çetnike morën dy fshatra në komunën e Suhodollit të Mitrovicës, ndërsa njësitet e tjera të tyre hynë në Peshter. Po kjo ndodhi edhe në disa fshatra të Gallapit. Më 28 qershor 1944 luftime të rrepta u zhvilluan veçanërisht në Kitkë mbi Hogosht dhe afër Preshevës. Këto luftime përfunduan me humbje të konsiderueshme për të dy palët. Me atë rast forcat ushtarake të Lidhjes së Dytë të Prizrenit që udhëhiqeshin nga Komanda e Përgjithshme e Rinisë për Mbrojtjen Kombëtare në përbërje Mulla Idrizi, Xheladin Kurbalia, Miftar Spahiu, Ibrahim Kelmendi, Sylë Hotla, Liman Staneci etj. iu kundërvunë forcave të Divizionit të 22-të të UNÇ e të AP për Serbi, përkatësisht njësiteve të Brigadës XIII Serbe dhe të ANÇP të Vrajës, të cilat pothuajse u shkatërruan krejt bashkë me spitalin e tyre që në atë kohë gjendej në Hogosht. Më 27.VII.1944 u zhvillua edhe një luftë tjetër në majën e Kitkës. Partizanët së bashku me forcat çetnike u përpoqën të depërtonin në drejtim të Hogoshtit. Lufta zgjati tërë ditën. Forcat partizano-çetnike ishin shumë më të mëdha, mirëpo forcave kufitare me të shpejtë u

arritën vullnetarët nga popullsia e kësaj ane dhe forcat çetniko-partizane u detyruan të tërhiqen me humbje të mëdha.

Nga fundi i majit 1944 njësitet e Korparmatës II të UNÇJ-së nën komandën e Peko Dapçeviqit mësynë në befasi në kurrizin e maleve Kacuberr e Smilovicë. Kacuberrri ishte mburojë natyrore për Rozhajën e Pejën dhe për gjithë Kosovën Perëndimore. Në mbrojtje të Smilovicës u nisën forcat vullnetare të Rugovës, të Lugut të Drinit dhe të Podgurit. Luftime të rrepta u zhvilluan më 30. dhe 31.V.1944 në majën e Smilovicës. Në këto përlëshje u vranë shumë burra të Rugovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit. Më 31.V.Sak Fazlija, bajraktari i Rugovës, vritet në majën e Smilovicës pa e lëshuar flamurin nga dora. Pas luftimeve disaditëshe, më 4–5.I.1944 forcat e Korparmatës II të UNÇJ-së arritën ta marrin Smilovicën dhe të shtinin në dorë edhe 6 fshatra të rrethinës së Petnicës, ndërkohë që forcat e tjera serbo-malazeze mësynë nga ana perëndimore e Tutinit. Njësitet e tjera iu drejtuan Rozhajës dhe pozicioneve të kufimbrotësve shqiptarë të Kolashinit të Vjetër. Luftime të rrepta u zhvilluan afër fshatit Murinë, ndërsa nga maja e Goleshit vazhduan goditjet me topa e mortaja në drejtim të vendit të quajtur Qafa e Xhamisë. Pazari i Ri, përveç luftëtarëve që i dërgoi në ndihmë Peshterit, ngriti në këmbë edhe një njësit të posaçëm, të afërt për mbrojtjen e qytetit. Po për mbrojtjen e këtij qyteti ishte parashikuar të dërgoheshin, në rast nevojë, luftëtarë nga Tutini e Rozhaja, ndërsa me angazhimin e dr. Sait Kazazit dhe të Halim Begesë nga Tirana, për në atë sektor të luftimeve u dërgua edhe batalioni “Besnik Çano”, i përbërë nga vullnetarë tiranas, durrsakë, shkodranë etj. Ky batalion arriti në Murinë më 20.VI.1944 dhe për tri ditë, pas luftimeve shumë të rrepta, rimori fshatrat Koritë, Doliq e Uglla, kurse njësitet serbo-malazeze u detyruan të tërhiqeshin për në Beranë. Në të njëjtën kohë forcat e prira nga Aqif Blyta vazhduan dëbimin e njësiteve çetnike nga Peshteri, ndërsa vullnetarët nga Suhodolli dhe fshatrat përreth u hodhën në kundërsulm dhe i përzunë repartet jugosllave jashtë vendbanimeve shqiptare. Luftimet më të rrepta u zhvilluan në mesnatën e 23/24.VI.1944, kur kundër njësiteve të mbrojtësve të Kacuberrit u vërsulen njësite të shumta të Korparmatës II të UNÇJ-së. Mbrojtësit u bënë ballë këtyre sulmeve dhe në përlëshjet që zgjatën deri në mëngjesin e 9.VII.1944 arritën të shpartallonin ofensivën e forcave jugosllave, që zgjati më se dy muaj. Për të sprapsur njësitet jugosllave nga këto vende strategjike shqiptare u angazhuan vullnetarë nga ana e Podgurit, Rugovës dhe Rozhajës. Ndërkaq, forcat shqiptare nga ana e Gjakovës dhe e Deçanit sulmuan pozicionet e njësiteve serbo-malazeze në bjeshkët e Roshkodolit të Isniqit. Pas luftimeve të rrepta, luftëtarët shqiptarë mundën t'i përzënë këto njësite nga fshatrat Llozna, Gogjevo e Ivanje të Peshterit.

Forcat çetnike sulmuan edhe nga ana lindore e Kosovës. Ato, pasi dëbuan me dhunë mbi 500 familje nga krahina shqiptare e Lebanës, iu vërsulën anës së Gjilanit. Që në kufi u ndeshën me rezistencën e fuqishme të mbrojtësve të fshatrave Shipashnicë e Epërme, Hogosht, Kopernicë, Sedllar, Kranidell e Çarr. Krahas formacioneve çetnike në këto luftime u angazhuan edhe njësite të UNÇJ-së, të cilat më 28.VI.1944 ia mësynë fshatit Velegllavë për të kaluar në drejtim të Bujanocit dhe të Pçinjës. Kundër tyre u ngrit njësi i vullnetarëve të Hogoshtit dhe popullsia e këtyre anëve, nën udhëheqjen e Sylë Zarbicës. Rezistencën në Kosovën Lindore e koordinonte *Shtabi i Mbrojtjes Kombëtare* me në krye mulla Idrizin, në bashkëpunim me Fuat Dibrën, komandant i Regjimentit IV të Ushtrisë Shqiptare. Forcat partizane serbe lëshuan Velegllavën dhe u hodhën në drejtim të fshatrave Poliçkë, Vryçec, Kranidell e Karaçevë. Ato u ndanë në dy grupe, njëri prej të cilëve kaloi vijën e demarkacionit dhe hyri në zonën e pushtuar nga bullgarët, ndërmjet Breznicës e Muhocit. Gjatë luftimeve forcat vullnetare shqiptare kapën 131 robër lufte.

Formimi dhe veprimtaria e Lidhjes së Dytë të Prizrenit

Në luftë kundër LANÇ të Shqipërisë dhe LNÇ të Kosovës e viseve të tjera etnike shqiptare, veç forcave pushtuese gjermane dhe bashkëpunëtorëve të tyre, u angazhuan edhe forca të tjera nacionaliste shqiptare. Natyrisht, këto organizata e orgaznima legale nuk ndiqeshin nga pushtuesit dhe bashkëpunëtorët e tyre përderisa ato nuk fillonin të luftonin drejtpërdrejt kundër interesave të këtyre forcave. E tillë ishte edhe Lidhja e Dytë e Prizrenit. Përgatitjet për formimin e kësaj organizate filluan menjëherë pas kapitullimit të Italisë fashiste. Qysh më 11.IX.1943 në Prizren u mbajt një mbledhje në të cilën u vendos që më 16.IX. të mbahet kuvendi themelues. Këshilli nismëtar i thirri në kuvend përfaqësuesit e Kosovës, të Dibrës, Strugës, Tuzit dhe të Ulqinit, ndërsa morën pjesë ata të prefekturave të Dibrës, Prizrenit, Pejës, Prishtinës, Mitrovicës dhe të Senicës. Punimet ky kuvend i përfundoi më 19.IX.1944. Mbledhja e dytë e Lidhjes së Dytë të Prizrenit u bë në Rogovë më 15–17.III.1944 me rend dite çështjen e kufijve, kurse tubimi i fundit i kësaj lidhjeje mbahet në Prizren më 27–10.VI.1944. Nismëtari kryesor për themelimin e kësaj lidhjeje ishte Xhafer Deva, ndërsa synimi kryesor i saj ishte “mbrojtja e vendit dhe e shqiptarëve”, të cilës i dha rëndësi edhe vetë Gjermania naziste. Kuvendi i kësaj lidhjeje shpalli bashkimin e Kosovës, Dibrës, Strugës, Ulqinit dhe Tuzit me Shqipërinë, ndërsa shprehu dëshirën që kështu të bëhej edhe me qarkun e Mitrovicës. Veç kësaj, në kuvend u trajtua edhe çështja e

organizmit politik dhe ushtarak dhe u zgjodh Komiteti Qendror i kësaj organizate (Rexhep Mitrovica /kryetar/, Musa Shehu /nënkryetar/, Kolë Margjini, Sheh Hasani, Tahir Zajmi dhe Qazim Bllaca), si dhe u miratua statuti i saj. Sipas këtij statuti, formoheshin Kuvendi, komitetet e qarqeve, rretheve, komunave dhe komitetet e fshatrave. Kuvendi e kishte qendrën në Prizren dhe përbëhej nga 14 anëtarë, ndërsa komitetet e tjera kishin qendrat në qarqe, rrethe e komuna dhe përbëheshin nga 7, përkatësisht 5 anëtarë. Në komitetet e fshatrave bënin pjesë kryepleqtë e tyre. Statuti i Lidhjes u pranua nga Këshilli i Lartë më 14.III.1944, ndërsa pas Rexhep Mitrovicës kryetarë të lidhjes u bënë Bedri Peja dhe Xhafer Deva. Organi i Lidhjes ishte *Lidhja e Prizrenit*, e cila përhapte idenë e Shqipërisë etnike dhe nevojën e mbrojtjes së saj, si dhe sulmonte komunistët shqiptarë si agjentë të Serbisë dhe të BRSS-së. Kryetari i saj Bedri Peja më 29.III.1944, me anë të një letre kërkoi nga Hitleri që të bëhet militarizimi i Kosovës dhe me ndihmën e saj të çliroheshin territoret shqiptare. Për këtë synim ai shpresonte se do të formonte një armatë prej 120.000 –150.000 vetësh, e cila do të luftonte kundër partizanëve serbo-malazezë deri në mbarim të luftës. Për të sendërtuar këtë synim, sipas Bedri Pejës, duhej siguruar armatim bashkëkohor, kuadër profesional ushtarak dhe ndihmë tjetër, që pritej nga Gjermania naziste. Po kështu Lidhja pajtohej që në prill të vitit 1944 të fillonte formimi i një divizioni SS, që u sendërtua me formimin e Divizioni të 21-të SS malor “Skenderbeg”. Letra dërguar Hitlerit mbeti vetëm letër, mirëpo Lidhja arriti të formonte degët e veta në të gjitha qendrat e prefekturave dhe të nënprefekturave të viseve etnike shqiptare jashtë kufijve të Shqipërisë së vitit 1913. Lidhja, po kështu, formoi KRNMK, i cili kishte për detyrë t’i mbronte kufijtë etnikë duke mobilizuar njerëz të moshës prej 18 deri 50 vjeç, kurse të vjetrit do të duhej të ndihmonin në sendërtimin e këtyre qëllimeve.

Komiteti Qendror i Lidhjes së Dytë të Prizrenit formoi edhe Komandën e Përgjithshme të Rinisë për Mbrojtjen e Kosovës. Ajo udhëhoqi qëndresën kundër njësiteve të UNÇJ-së, kurse forcat ushtarake të saj quheshin vullnetarë. Këtë veprimtari kjo lidhje e zhvilloi deri më 17 nëntor 1944, kur njësitet e UNÇJ-së kishin ripushtuar pothuajse pjesën më të madhe të Kosovës dhe të viseve të tjera etnike. Kështu, në periudhën shtator 1943 e deri në nëntor 1944 Lidhja e Dytë e Prizrenit ishte organizmi më i rëndësishëm politik nacionalist në Kosovë. Ajo udhëhoqi qëndresën e armatosur kundër UNÇJ-së, por edhe aleatit të saj – UNÇSH-së.

Komiteti i Rinisë Nacionaliste për Mbrojtjen e Kosovës

KRNMK u formua në Prishtinë në fillim të shtatorit të vitit 1944. Në tubimin e formimit të tij, në të cilin morën pjesë qytetarë të Prishtinës e të rinj të kësaj ane foli Xhafer Deva, ndërsa ishin të pranishëm dr. Rexhep Krasniqi, Xhelal e Rexhep Mitrovica, Bedri Peja, Ymer Berisha, Ibrahim Kelmendi, Jahja Fusha, Hysen Prishtina, Jusuf Agushi e autoritete të tjera. Avokati Idriz Shahmani, nismëtari i këtij komiteti, mbajti referatin mbi rrezikun që paraqiste komunizmi për Shqipërinë dhe mbështetur në këtë u miratua *Disiplinari i Rinisë Nacionaliste Shqiptare për Mbrojtjen e Atdheut dhe të Kombit Shqiptar*. Pastaj u zgjodh Komiteti Qendror i Rinisë Nacionaliste i përbërë prej 9 vetësh: Adem (Selim) Gllavica, kryetar dhe anëtarë Sali Vala – Siçani, Luan Gashi, Abdyl Henci, Shabsivar Aliu etj. Veç kësaj, në këtë tubim u vendos që të formoheshin batalionet e moshës 1910 – 1917 dhe batalionet e moshës 1917 – 1927, pa marrë parasysh rangun dhe titullin në shoqëri, të mblidheshin ndihma dhe pjesëtarët e këtij komiteti të vënin shami të kuqe me germa të zeza, në të cilat do të shkruhej: *Mbrojtja e Kosovës*. Po kështu u vendos që në kuadër të këtij komiteti të formoheshin dhe të punonin seksioni ushtarak, propagandues, financiar dhe seksioni transportues, kurse në Ferizaj dhe Gjilan të formoheshin komitetet e rretheve të modelit të njëjtë me Komitetin e Qarkut të Prishtinës. Pasi këto seksione do të duhej të kishin rol të rëndësishëm, u zgjodhën edhe kryetarët e tyre. Kryetar i Seksionit për Financa u zgjodh Shabsivar Aliu. Ky ishte seksioni kryesor i këtij komiteti dhe kishte për detyrë të mbante dhe të grumbullonte ushtrinë. Seksioni Ushtarak duhej të mobilizonte dhe të organizonte ushtrinë, kurse kryetar i tij u emërua Abdyl Henci. Detyrën e Seksionit Propagandues e kryenin Shemsedin Venderesi dhe Luan Gashi, kurse kryetar i Seksionit Transportues, që do të kujdesej për transport dhe për materialin e ushqimin e dërguar në fushën e luftës, u zgjodh Salih Vala – Siçani. Komiteti Qarkor i Lidhjes së Dytë të Prizrenit në Prishtinë veproi edhe pas formimit të këtij komiteti. Ai pushoi së vepruari vetëm pas fillimit të formimit të batalioneve të KRNMK, kur ekzistenca e tij u bë e pakuptimtë.

Puna e KRNMK-së në formimin e batalioneve ushtarake të mbrojtjes filloi në shtator të vitit 1944. Në fund të këtij muaji në Prishtinë nga shqiptarët (por edhe të tjerët) e rrethve të Prishtinës, të Llapit, të Ferizajt, të Gjilanit u formuan katër batalione. Batalioni i Parë me emrin “Nazim Gafurri” u formua kryesisht nga të mobilizuarit e rrethit të Prishtinës. Komandant i tij ishte Salih Vala – Siçani. Ky batalion në fillim kishte 180 të rekrutuar e më vonë arriti të mobilizojë 300 vetë, të lindur kryesisht midis viteve 1910 – 1917. Nga fshatarët e vendbanimeve përreth Prishtinës u

formua Batalioni i Dytë i quajtur “Hasan Prishtina” me më se 300 luftëtarë. Komandant i tij u emërua Ibush Ibrahim. Edhe Batalioni i Tretë kishte mbi 300 luftëtarë, kurse Batalioni i Katërt ishte ai i rinisë, në të cilin u përfshinë të lindurit midis viteve 1917 – 1927 dhe quhej “Zija Gashi”, ndërsa komandant i tij u emërua Selim Maçastena. Komandant i përgjithshëm i këtyre batalioneve u emërua Shahsivar Aliu. Më vonë u formuan edhe batalionet e Drenicës, Llapit dhe të Sanxhakut.

Të katër batalionet e KRNMK-së do të duhej të ishin mbështetje për mobilizimin e shqiptarëve në luftë kundër LNÇ-së në Kosovë dhe në viset fqinje. Në secilin batalion kishte nga katër çeta, tri të prapavijës dhe një mitraliere me nga dy mortaja dhe me nga 4 – 5 mitraloza. Gjatë muajve tetor e nëntor të vitit 1944 të katër batalionet luftuan në vijën kufitare me Serbinë, veçanërisht në Prapashticë, Koliq, Keqekollë, Lisicë dhe Orllan. Të mobilizuarit kishin uniforma gjermane, por mbanin plisa me shkabën dhe flamurin shqiptar.

KRNMK krahas organizimit ushtarak u angazhua edhe në veprimtarinë propaganduese, e cila u shqua veçanërisht në tetor të vitit 1944, por ajo kishte filluar qysh në fund të shtatorit të atij viti e kishte vazhduar deri në “çlirimin” përfundimtar të Kosovës. Kjo propagandë bëhej duke shfrytëzuar forma e metoda të ndryshme propaganduese siç ishin shpalljet dhe proklamatat e ndryshme drejtuar popullit shqiptar, por edhe serbëve dhe bullgarëve. Shpallje të tilla u shpërndanë më 27. IX dhe më 2, 17, 19, 24, 26 dhe më 30.X.1944.

Veprimtaria e forcave çetnike

Pas kapitullimit të Italisë fashiste lëvizja çetnike vinte duke u dobësuar gjithnjë e më shumë. Falë rrethanave dhe rrjedhave të luftës kjo lëvizje iu afrua edhe më shumë pushtuesve gjermanë dhe së bashku me qeverinë e Nediqit bënë përpjekje për formimin e frontit të përbashkët kundërkomunist. Mirëpo, qëndrimet e çetnikëve ndaj shqiptarëve as në këtë kohë nuk ndryshuan. Shpërngulja masive dhe pastrimi etnik i shqiptarëve, si dhe hakmarrja kolektive ishin dhe mbetën synimet kryesore të çetnikëve. Sendërtimi i këtyre synimeve përpiqej të bëhej nëpërmjet organizatave çetnike në Kosovë, si dhe Korparmatës së Parë dhe Korparmatës së Dytë Çetnike të Kosovës në terrenet e afërta të Serbisë. Në fund të vitit 1943 dhe në fillim të atij 1944 përparim i ndjeshëm i ndikimit të çetnikëve ishte bërë në terrenet e Prishtinës dhe të Kaçanikut, ku më parë ishin dërguar treshe dhe agentë me detyra speciale, por nuk ishin jashtë synimeve të tyre të kohës as Kaçaniku e Gjilani, ku shpërndahej material propagandues dhe

bëheshin organizime të tjera. Veç kësaj, në këtë kohë numri i çetnikëve në Korparmatën e Dytë u shtua mjaft për shkak të refugjatëve të Kosovës që shkuan në Luginën e Ibrit dhe pothuajse që të gjithë iu bashkëngjitën çetnikëve, ndërsa hakmarrja kundër shqiptarëve ishte së tepërmi e theksuar dhe si e tillë mbeti edhe deri në fund të luftës, prandaj përpjekjet e kreut çetnik që të lidheshin me disa autoritete shqiptare mbetën të pasuksesshme.

Këshillimi i Sharrit dhe përgatitjet për Konferencën e Bujanit

Këshillimi i KK të PKJ-së për Kosovë e Metohi në Sharr u mbajt më 4 – 6.XI.1943. Në të, veç një numri të anëtarëve të KK të PKJ-së, morën pjesë edhe disa delegatë e komitete të vendeve. Këshillimi miratoi rezolutën e cila kishte dy pjesë: pjesën politike dhe pjesën organizative. Në pjesën politike flitej për sukseset e Armatës së Kuqe dhe kapitullimin e Italisë fashiste, si dhe për sukseset e UNÇJ-së në zhveshjen e pushtuesve dhe të bashkëpunëtorëve të tyre, pastaj për demonstratat në Prizren, Prishtinë e Gjakovë në shkurt të vitit 1943, detyrat e ardhshme për ndërtimin e mëtejshëm të këshillave nacionalçlirimtarë, luftën për zhveshjen e “reaksionit”, si dhe për popullarizimin e parullës për pushtetin e vërtetë demokratik, i cili të gjithë popujve do t’u sjellë të drejta, liri të plotë, pavarësi dhe të drejtën për vetpërcaktim. Pasi përmenden rezultatet e arritura, me një vëmendje të veçantë të depërtimit të masat shqiptare, si dhe pasi pohohet se pas kapitullimit të Italisë fashiste janë formuar dy komitete qarkore të PKJ-së (për Kosovë e Dukagjin) dhe disa njësite partizane, si dhe se është bërë punë e ndjeshme jo vetëm në organizatat e PKJ-së, por edhe në ato të rinisë dhe të gruas, theksohet se njëra nga detyrat më të rëndësishme në të ardhmen konsiderohej formimi i KK NÇ për Kosovë e Metohi, i cili do të ishte “përfaqësuesi më i lartë politik në krahinë”. Në të, sipas këtij këshillimi, do të duhej të mermin pjesë të gjithë pa marrë parasysh përkatësinë kombëtare e fetare, si dhe orientimet ideore, por kryesore do të ishte lufta kundër pushtuesve dhe bashkëpunëtorëve të tyre, e cila do t’u garantonte popujve pas luftës të drejtën e vetëvendosjes. Se ishte kështu shihej edhe nga raporti i KK të PKJ-së për Kosovë e Metohi që iu dërgua KQ të PKJ-së më 31.I.1944, në të cilin, veç tjerash, për gjendjen organizative theksohej se komitetet e vendeve ekzistonin në Pejë, Gjakovë, Prizren, Ferizaj, Preshevë, Prishtinë, “Trepçë” dhe në Mitrovicë, kurse komitetet e rretheve në Pejë, Prizren, Ferizaj, Gjilan dhe në Prishtinë. Organizata të PKJ-së nuk ishin formuar në rrethin e Dragashit dhe në atë të Suharekës, por ekzistonin vetëm pika. Shumica e anëtarëve të PKJ-së ishin serbë e malazezë, ndërsa numri i shqiptarëve ishte fare i vogël, veçanërisht në rajonin e Komitetit Qarkor për

Kosovë. Në atë kohë besohej se ishin gjithsej 400 anëtarë, prej të cilëve vetëm 45 shqiptarë (shtatë prej tyre gra me ferehe e peçe).

Një gjendje e tillë partiake në Kosovë, me ndryshime të vogla, mbizotëroi deri në fundin e nëntorit të vitit 1944. Brenda kësaj kohe iu kushtua kujdes i madh masivizimit dhe zhvillimit të organizatave antifashiste, si dhe luftës për bashkimin e masave në FPNÇ, mirëpo ato nuk ndikuan ndjeshëm në ndryshimin e gjendjes organizative dhe të përbërjes së PKJ-së në Kosovë. Shpalljet, urdhërat dhe artikujt e ndryshëm në gazetën *Liria*, si organ i këtij fronti, mbetën format e vetme të kësaj lufte. Në këtë kuadër hyjnë edhe dokumentet e KQ të PKJ-së dhe të KQ të PKSH-së, por edhe të KQ të Serbisë, dërguar KK të PKJ-së për Kosovë dhe Metohi.

Konferenca e Bujanit (31.XII.1943 – 1 dhe 2.I.1944)

Idea për formimin e KK të NÇ-së për Kosovë e Metohi vinte duke u formësuar gjithnjë e më shumë pas Mbledhjes së Parë të KAÇKJ-së. Këtë ide për herë të parë e dhanë në muajin shkurt të vitit 1943 Boris Vukmiroviq, sekretar i KK të PKJ-së, dhe Ramiz Sadiku, anëtar i këtij komiteti. Në këtë frymë u bënë disa përgatitje, por rrethanat e luftës nuk lejuan që ajo të sendërtohej. Me kohë rrethanat do të ndryshonin dhe deri më 26.IX.1943 u bënë përpjekje për përtëritjen dhe formimin e KKNÇ-ve në territorin e Prizrenit, Gjakovës e të Pejës. Diçka e tillë pritej të bëhej në Istog, Rakosh dhe Drenicë. Në tetor të vitit 1943 u formua KKNÇ i Përkohshëm për Kosovë e Metohi, ndërsa vendimin për mbajtjen e Konferencës Themeluese të KKNÇ-së për Kosovë e Metohi e mori Këshillimi i KK të PKJ-së në Sharr. Duhet shtuar se, veç tjerash, vendimi për mbajtjen e kësaj konference u bë edhe si kundërpeshë e veprimtarive të ndjeshme të organizatave nacionaliste, siç ishin Lidhja e Dytë e Prizrenit, Balli Kombëtar, Legaliteti etj.

Konferenca Themeluese e KKNÇ për Kosovë e Metohi u mbajt më 31.XII.1943 dhe më 1 e 2.I.1944 në Bujan të Malësisë së Gjakovës. Në të morën pjesë përfaqësuesit e këshillave nacionaqlirimtarë në qendrat kryesore dhe në fshatra, përfaqësuesit dhe komunistët e dalluar nga njësitet partizane, por edhe nga e gjithë Kosova. Ishin ftuar të vinin 61 delegatë, por për shkak të kushteve arritën 49 prej tyre, 46 prej të cilëve ishin shqiptarë. Këtë konferencë e hapi Xhevdet Doda, ndërsa Konferencën e përshëndetën komandanti i SHK të UNÇ e AP për Kosovë e Metohi Fadil Hoxha, sekretari i KK të PKJ-së për Kosovë e Metohi Pavle Joviçeviq, delegati i BRKJ-së dhe i FAG-ut për Kosovë e Metohi, pastaj delegati i Krasniqes, delegati i Brigadës I Maqedono – Kosovare dhe përfaqësuesi i misionit

ushtarak anglez në SHK të UNÇ e AP për Kosovë e Metohi. Në vazhdim iu dërgua letër përshëndetëse KAÇKJ-së, SHS të UNÇ e APJ-së, SHK të UNÇ e AP për Kosovë e Metohi, Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH-së dhe Këshillit të Përgjithshëm NÇ të Shqipërisë. Të nesërmen u lexuan referate nga Mehmet Hoxha, Xhavit Nimani etj. që u shoqëruan edhe me diskutime. Në fund Konferenca Themeluese zgjodhi Kryesinë e KKNÇ të përbërë prej kryetarit (Mehmet Hoxha), dy nënkryetarëve dhe gjashtë anëtarëve, kurse KKNÇ përbëhej nga 42 anëtarë. Po kështu Konferenca miratoi Rezolutën dhe Shpalljen si dokumente të saj mbështetëse. Në to thuhej se populli shqiptar e ka kuptuar në mënyrë të qartë se çfarë “lirie” i duhet, mirëpo vehej në dukje se rreth pushtuesit fashist janë tubuar organizata të ndryshme nacionaliste dhe kuislinge, sikurse janë “Balli Kombëtar, “Lidhja e Dytë e Prizrenit”, çetnikët e Drazha Mihailoviqit dhe ithtarët e Nediqit. Edhe ballistët edhe çetnikët, sipas këtyre dokumenteve, luftonin kundër LNÇ-së. Të parët propagandonin parullën për “Shqipërinë e Madhe”, të dytët për “Jugosllavinë e Madhe”, kurse qëllimi i tyre është i njëjtë: të ruhej sistemi i vjetër. Në dokumentet e përmendura, po kështu, theksohej se në Konferencën Themeluese të KKNÇ-së delegatët e tubuar dhe të bashkuar e kanë zhveshur dhe dënuar politikën e “reaksionit” dhe kanë pohuar se vetëm lufta nacionalçlirimtare kundër fashizmit është rrugë për të fituar liri dhe jetë të lumtur për popullin, garanci se popujt do të kenë të drejtë të vendosin vetë për fatin e tyre, pa u përzier askush. Në këto dokumente ftohen popujt e kësaj treve në luftë të vendosur e të përbashkët kundër pushtuesit dhe bashkëpunëtorëve të tij në bashkëpunim me popujt e tjerë të Jugosllavisë. Kjo luftë, sipas shpalljes dhe rezolutës së kësaj mbledhjeje, popujve do t’u sigurojë edhe të drejtën e vetëvendosjes deri në shkapitje, ndërsa ajo do të duhej të zhvillohej nën parullat “Gjithçka për front – gjithçka për fitore”, “Në luftë kundër okuparit dhe tradhtarëve”.

Mohimi i Konferencës së Parë Themeluese të KKNÇ-së

Mbajtja e Konferencës Themeluese të KKNÇ për Kosovë e Metohi, në veçanti Rezoluta dhe Shpallja si akte mbështetëse të saj, si dhe formimi i komiteteve qarkore dhe ngritja e Komitetit Qarkor (serbisht Oblasni) në atë Krahinor (serbisht Pokrajinski) shqetësoi së tepërmi KQ të PKJ-së dhe të gjitha organet e UNÇJ-së. Kjo më së miri shihet në letrën e KQ të PKJ-së dërguar KK të PKJ-së më 28.III.1943, që në të vërtetë ishte akti i parë i këtij organi dërguar në Kosovë pas mbajtjes së kësaj mbledhjeje dhe që njëherësh ishte përgjigjeje në letrën e KK të PKJ-së të 31.I.1944 dhe të mbajtjes së Konferencës Themeluese të KK NÇ për Kosovë e Metohi.

Pasi në letrën e përmendur pohohet se organizata e Partisë në Kosovë, si dhe udhëheqjet e saj kanë treguar vendosmëri, vetëmohim dhe besnikëri në luftë për Partinë dhe për LNC-në, për “shkak të largësisë dhe të lidhjeve të rralla” kjo organizatë ka bërë edhe lëshime të ndjeshme. Lëshim dhe gabim i madh, sipas KQ të PKJ-së, ishte “ndërrimi” i emrit Metohi në Dukagjin, pasi kinse Dukagjini përfshin edhe disa vise të cilat nuk kanë qenë territor i Jugosllavisë së Vjetër. Megjithatë, po sipas këtij organi, ky emër mund të mbetej në qoftë se populli e quan ashtu! Kështu nuk mund të ndodhte me ngritjen e komitetit qarkor në komitet krahinor dhe me formimin e dy komiteteve qarkore dhe si pasojë kjo do të duhej të “përmirësohej” menjëherë, pra të degradohej organi më i lartë i PKJ-së për Kosovë e Metohi. Po kështu, sipas KQ të PKJ-së, për kohën nuk do të duhej të flitej asesi për kufijtë me Shqipërinë, sepse kjo çështje do të zgjidhej pas lufte, ndërsa sa i përket karakterit të KKNÇ për Kosovë e Metohi ky organ ka vërejtje të madhe dhe të rreptë. Sipas tij KKNÇ për Kosovë e Metohi mund të ishte vetëm këshill nismëtar, mund të ishte organ i bashkimit politik të masave e nga do të duhej të kishte kurrsezi karakter të pushtetit, megjithëse do të kishte për detyrë të udhëhiqte këshillat më të ulta. Me fjalë të tjera, KQ të PKJ-së e pengonte karakteri i pushtetit i KKNÇ-së, si dhe çdo përpjekje që shpiente të bashkimi i natyrshëm i Kosovës dhe i viseve të tjera etnike shqiptare me Shqipërinë, pra edhe parimi i patjetërsueshëm i vetëvendosjes dhe shkëputjes. Ai ishte kundër çdo “Shqipërie të Madhe” dhe “Jugosllavie të Madhe”, sepse kjo e fundit edhe ashtu ishte e madhe dhe si e tillë nuk do të duhej të ndryshohej fare. KQ i PKJ-së konsideronte se nuk do të duhej të flitej për “njësimin” me Shqipërinë, sepse në këtë moment nuk është fjala për caktimin e kufijve midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë (që të dyja të pushtuara nga ana e Gjermanisë), por që të dyja këto vende me luftë të armatosur do të duhej të çliroheshin prej pushtuesit nazist. Në letër pastaj theksohej se do të ishte gabim thelbësor po të paraqiteshin apo të zgjidheshin cilatdo çështje kontestuese, sepse ato mund të zgjidheshin në mënyrë të drejtë vetëm nga ana e popujve të lirë, pas luftës.

Qëndrimin e KQ të PKJ-së në letrën e 28.III.1944 shumë pjesëtarë dhe përkrahës shqiptarë të LNC-së nuk e përkrahën dhe i lëshuan radhët e saj. Të tjerët vazhduan veprimtarinë e nisur dhe u detyruan që këto qëndrime t’i përkrahnin e t’i zbatonin. Në këtë frymë ishte edhe letra e KK të PKJ-së e 18.VI.1944, e cila iu dërgua të gjitha instancave më të ulta të Partisë dhe të organizmave të tjerë të LNC-së. Ky në të vërtetë ishte gjunjëzimi i parë i hapur i LNC të Kosovës dhe atë mu në kohën kur lufta kishte marrë përmasa të mëdha. Edhe në këto rrethana punonte e vepronte KNÇ në Gjilan dhe në Gjakovë, ndërsa ato në Prishtinë, Ferizaj, Mitrovicë kishin hasur në vështirësi të theksuara.

Veprimtaria e nacionalistëve shqiptarë

Pas kapitullimit të Italisë fashiste, veç organizmave të përmendur kombëtarë, ndikim i ndjeshëm u hetua edhe në radhët e nacionalistëve të ndryshëm në Kosovë dhe në viset e tjera etnike, të cilët nuk kishin arritur të formësoheshin në kuptimin e plotë të fjalës, por ndikimi i tyre ishte i ndjeshëm, ndërsa disa prej tyre arritën të formonin dhe të angazhonin forca të konsiderueshme të armatosura. Në shtimin e numrit të shqiptarëve për këto orientime edhe pas shtatorit të vitit 1943 ndikuan shumë faktorë, mirëpo kryesori ishte qasja zgjidhjes së çështjes së Kosovës. Në këtë periudhë sikur edhe më herët pati nacionalistë që pranonin të luftonin kundër pushtuesve nazistë, mirëpo asesi nën tutelën e PKJ-së dhe LNÇJ-së dhe as të PKS-së e të UNÇSH-së.

Në pjesët me kufijtë me Shqipërinë e vitit 1913 ndikim të ndjeshëm kishte edhe Balli Kombëtar. Kjo organizatë arriti të bënte për vete edhe shumë njerëz të Pejës, madje edhe vetë prefektin e këtij qyteti Hasan Begollin, i cili ishte krah i djathtë i tij. Për ide balliste në këtë qytet kishin rënë në sy edhe Haris T(h)anasi, Teufik Begolli dhe Hysen Murati me shokë. Harisi madje kërkonte organizimin e çetave balliste në luftën e hapët kundër LNÇ-së, ndërsa kundërshtojë nga Hasani e Teufiku, ngase sipas tyre nuk do ta kishin mbështetjen e masave. Ndikimi i Ballit Kombëtar në Pejë ishte aq i madh sa u ra në sy edhe organeve pushtuese gjermane, të cilat për ndalimin e veprimtarisë së tij në këtë qendër ia tërhoqën vërejtjen prefektit e madje edhe iu kërcënuan se nëse nuk ndërmerri masa kundër tij do të shkarkohej. Po në këtë kohë në Pejë Legaliteti kishte marrë hov ndër oficerë. Dy të tretat e oficerëve ishin anëtarë të kësaj partie. Më i dalluari ishte Miftar Jegeni, kapiten i xhandarmërisë, pastaj kapteri i ushtrisë Ramë Vojvoda, Qerim Begolli etj.

Formë të caktuar organizative Balli Kombëtar kishte marrë edhe në shkollën normale “Sami Frashëri” në Prishtinë, duke përfshirë në radhët e veta një pjesë të profesorëve dhe të nxënësve. Në krye të kësaj organizate ishin Vasil Antoni dhe Luan Gashi. Më vonë në këtë organizatë me veprimtarinë e tij u shqua nxënësi që erdhi nga Shqipëria, i cili pas kapitullimit të Italisë fashiste u përpoq të bëjë riorganizimin e kësaj organizate, veçanërisht në frymën kundëritaliane. Megjithatë, ndikimi i kësaj organizate as në periudhën para shtatorit të vitit 1943 dhe as pas kësaj periudhe nuk ishte i ndjeshëm. Ajo pengojë si nga pushtuesit italianë ashtu edhe nga veprimtaria komuniste, e cila në këtë shkollë kishte marrë formë të konsiderueshme. Sipas udhëheqësve të LNÇ-së, kjo organizatë kishte marrë formë të konsiderueshme edhe në Maqedoninë Perëndimore.

Me veprimtari kombëtare në këtë kohë ishte dalluar edhe Emrush Miftari me shokë. Ky pjesëmarrës i Luftës së Spanjës që në Pejë ishte kthyer në tetor të vitit 1943 me 25 shokët e tij, por edhe me shumë përkrahës të tjerë e me ndikim, ndër ta edhe disa femra, ishte bërë i njohur jo vetëm për Pejë e rrethinën, por edhe më gjerë. Kundër tij haptas nuk mund të shpreheshin as bartësit e LNÇ-së, por pasi ndikimi i tij ishte i madh ata bënëin çmos që me dredhi së pari ta njollosnin e pastaj edhe ta zhduknin fizikisht. Bartësit shovinistë të LNÇ-së në këtë anë dhe shërbëtorët e tyre të verbër i pengonte në veçanti orientimi kundërmazifashist i Emrush Miftarit, i cili kurrë nuk u pajtua që Kosova të mbetej nën thundrën e jugosllavëve. Bartësit dhe pjesëtarët e LNÇ-së i pengonte shumë edhe autoriteti i Sadik Ramë Gjurgjevikut, prandaj nga ai kërkonin të formonte çetën e vet ose të shkonte e t'i bashkëngjitej Shtabit të Zonës Operative. Bartësve dhe pjesëtarëve të LNÇ-së në Maqedoni u kishte rënë në sy edhe e dhëna se Haxhi Lleshi as ndaj Ballit Kombëtar dhe as ndaj "shqiptaromëdhenjve" nuk kishte qëndrim të prerë, sikurse e dhëna se me "shqiptaromëdhenjtë" bashkëpunonte e gjithë Dibra. Në Kosovë në të njëjtën kohë ndikim të madh në popull kishte Ramë Muja, i cili ishte kundërmazist, por nuk dëshironte t'u nënshtrohej urdhërave të jugosllavëve. Megjithatë, ai dëshironte të bashkëpunonte me LNÇ-në në Kosovë, në veçanti me Fadil Hoxhën, dhe ky bashkëpunim nuk mund të mohohet deri në degradimin e SHK të UNÇ e AP për Kosovë e Metohi në SHO të UNÇ e AP, kur ky bashkëpunim u ndërpre plotësisht dhe Ramë Muja filloi të ndiqet haptazi nga UNÇJ. Ç'është e vërteta, ky autoritet kundërmazifashist nga UNÇ-ja filloi të vrojtohej me mosbesim që nga prilli i vitit 1944, kur "kishte fituar të drejtën e ruajtjes së kufirit" dhe që atëherë kishte filluar mobilizimin për ruajtjen e kufijve etnikë.

Marrëdhënie të ngjashme si me Ramë Mujën LNÇ-ja kishte edhe me vëllezërit Kryeziu, veçanërisht me Gani bej Kryeziun, mirëpo disa nga udhëheqësit dhe bartësit e LNÇ-së në Kosovë "nuk kishin mendim të keq" për asnjërin prej këtyre vëllezërve, që natyrisht kështu nuk mendonin të gjithë, në veçanti shovinistët serbë, që vepronin në petkun komunist. Ndryshe s'kishte si të ndodhte kur që në janar të vitit 1944 vëllezërit Kryeziu (Ganiu, Hasani e Sahiti) me bashkëmendimtarët e tyre u nisën në luftë kundër pushtuesit. Këta kundërmazistë duhej të përfitoheshin dhe nuk ishte pa arsye që me ta edhe të bashkëpunoheshin dhe të këshilloheshin. Kjo ishte arsyeja që ky bashkëpunim ishte i ndjeshëm midis LNÇ-së së Kosovës, sërish sidomos me komandantin e SHK të UNÇ e AP për Kosovë e Metohi, Fadil Hoxhën dhe vëllezërit Kryeziu. Vëllezërit Kryeziu nuk mund të injoroheshin edhe për shkak se ata kishin ndikim të madh edhe te misioni i aleatëve, me ç'rast shquheshin përfaqësuesit e misionit aleat anglez, që nuk

mund të thuhej as për SHK të UNÇ e AP për Kosovë e Metohi e as për SHK të UNÇSH-së. Këto detyruan SHK të UNÇ-së e AP për Kosovë e Metohi që deri në gusht të vitit 1944 të bashkëpunonin ngushtë me forcat e vëllezërve Kryeziu, e madje edhe t'i udhëzonin njësitet e tyre që për shumë veprime të armatosura më parë të këshilloheshin me këto forca. Në këtë kohë komunistët u gjunjzuan nga presioni i përhershëm që u bëhej për bashkëpunimin e tyre me nacionalistët shqiptarë dhe ata u pajtuan që ata që nga kjo kohë të shpalleshin kundërshtarë të LNÇ-së. Ishte e kotë shpallja e Gani bej Kryeziut ku ftoheshin shqiptarët “në luftë kundër gjermanëve ja sot, ja kurrë”, si dhe mobilizimi nga ana e tij e 200 – 300 shqiptarëve në luftë kundër pushtuesve fashistë. I kotë ishte edhe aksioni i përbashkët me partizanët për “çlirimin” e Gjakovës. Në gjysmën e shtatorit lufta me LNÇ-në u bë e pakapërcyeshme dhe mosbesimi i dyanshëm doli në shesh. Në këtë kohë luftimet ishin pothuajse të përhershme dhe të shpeshta me shkallë të ndryshme. Ndër luftërat e këtyre forcave ishin ato në aksin rrugor Prizren – Gjakovë, por më të dalluarat ishin lufta e Gjakovës, Deçanit dhe e Qafë-Prushit. Udhëheqës nacionalistë të këtyre luftimeve ishin vëllezërit Kryeziu, Demë Ali Pozhari, Ali Bokshi, Ago Agaj, Salih Hoxha, Sefedin Begolli, Hysen e Sahit Bajraktari Mehmet Aliu e të tjerë.

Formimi i njësiteve të armatosura të LNÇ-së dhe veprimtaria e tyre

Që nga kapitullimi i Italisë fashiste deri në ripushtimin përfundimtar të Kosovës dhe të viseve të tjera etnike PKJ, veç veprimtarisë politike që përherë çonte ujë në mullirin e ripushtimit të Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare, vazhdonte të bënte çmos që të formonte sa më shumë formacione të veta të armatosura. Natyrisht, për të nxjerrë gështenjat nga zjarri dhe për demagogji, kjo parti përpiqej që në këto formacione të fuste sa më shumë shqiptarë, ndërsa kur nuk kishte nga t'ia mbante formonte edhe njësite të pavarura partizane. Kjo ishte arsyeja që SHK i UNÇ e AP për Kosovë e Metohi që edhe më 9.IX.1943 u drejtoi një shpallje popujve të kësaj krahine duke i ftuar të hyjnë në njësitet partizane dhe të luftojnë kundër pushtuesit gjerman e bullgar. Në kryengritje thirren veçmas shqiptarët e këtyre viseve, sepse sipas tyre kjo ishte e vetmja mënyrë e çlirimit të popullit shqiptar. KK i PKJ-së që herët kishte kërkuar nga komitetet vendore të PKJ-së që njerëzit të cilët dëshironin të luftonin t'i dërgonin në drejtim të Jabllanicës së Epërme ku gjendej Zona e Parë Operative dhe në drejtim të Malësisë së Gjakovës ku gjendej Zona e Dytë Operative e UNÇ për Kosovë dhe Metohi dhe vetë SHK i UNÇ-së e AP-së. Ky komitet veproi kështu edhe më 28.IX.1943, por edhe më 6.X.1943. Kjo ishte e natyrshme, ngase në raportin

e KK të PKJ-së dërguar KQ të PKJ-së më 31.I.1944, veç tjerash, theksohej se ishte e dobët gjendja për sa i përket formimit të njësiteve partizane, sepse njësitet e përbëra nga serbët e malazeztë, në kohë të fundit edhe ato të përbëra nga shqiptarët, nuk mund të qëndronin e të vepronin në Kosovë. Megjithatë, njësitet partizane nga Kosova edhe pas kapitullimit të Italisë fashiste u formuan njëra pas tjetrës, kryesisht në viset etnike shqiptare apo edhe në ato të përziera.

Prej kapitullimit të Italisë fashiste e deri në nëntor të vitit 1944 në Kosovë dhe në viset e tjera etnike vazhduan të formoheshin njësite të llojshme të UNÇ-së që nga aradhat e deri te brigadat. Kështu brenda kësaj periudhe u formua Aradha Nacionalçlirimtare Partizane (ANÇP) e Kosovës dhe e Metohisë (më 22.X.1943), ANÇP e Shalës (nga fundi i gushtit 1944), ANÇP e Rakoshit (fillim të tetorit 1944), ANÇP e Drenicës (nga gjysma e këtij muaji), ANÇP “Curri – Rexhepi”, që u formua nga aradha “Perlat Rexhepi” e UNÇSH-së dhe aradha “Bajram Curri” e UNÇ e AP për Kosovë e Metohi (12.I.1944), ANÇP e Ibrit (3 /4.XI.1944), ANÇP e Kosmetit (7.XI.1944), pastaj Çeta Partizane e Krajës dhe i Çeta Partizane e Tuzit (nëntor 1943), Çeta e Kosovës (13.IV.1944), Çeta e Lumës, Çeta e Hasit, si dhe Batalioni i parë kosovar “Ramiz Sadiku” (16.IX.1943), Batalioni “Boris Vukmirovic”, Batalioni i parë i Dibrës “Nazmi Rushiti” (fundit i tetorit 1943), Batalioni i Parë (21.XI.1943) dhe Batalioni i Dytë Kosovar (29.XII.1943), Batalioni “Kosova” (gjysma e majit 1944), Batalioni Sulmues i Kosmetit (fundit i majit 1944), Batalioni “Kosova” (fundit i qershorit 1944) dhe Batalioni partizan “Meto Bajraktari” (28.IX.1944). Këto njësite u formuan në Shqipëri, Maqedoninë Perëndimore dhe në Mal të Zi, ndërsa numri i tyre sillej përafërsisht nga 60 deri në 220 të armatosur, me përjashtim të ANÇP të Ibrit, e cila kishte prej 700 deri 1.000 të armatosur, kryesisht të shpërngulur nga Kosova.

Për shkak të shtimit të numrit të këtyre njësiteve, por edhe për shkak të riorganizimit ushtarak me kohë filluan të formoheshin edhe brigadat partizane. Deri në muajin nëntor të vitit 1944 SHK i UNÇ-së e AP-së për Kosovë e Metohi formoi pesë brigada të saj. Brigada I Sulmuese NÇ e Kosovë e Metohisë u formua afër fshatit Zbazhdi në afërsi të Strugës, më 24.VI.1944. Ajo kishte tri batalione dhe një çetë përcjellëse. Më 9.IX. në fshatin Lilancë afër Bujanocit u formua Brigada II NÇ e Kosovës e Metohisë me katër batalione dhe 450 luftëtarë. Në rajonin e Vrajës, në fshatin Krajmirovic, më 12.IX. u formua Brigada III NÇP e Kosovës e Metohisë. Ajo kishte tri batalione me 450 luftëtarë. Më vonë, më 13.X. në Krumë të Shqipërisë u formua Brigada IV e UNÇ e AP për Kosovë – Metohi prej dy batalionesh me gjithsej 400 luftëtarë. Në fshatin Tullar më 24.IX.1944 u formua Brigada V e UNÇ e AP për Kosovë e Metohi me katër

batalione. Shumë kosovarë shqiptarë, serbë e malazezë pati edhe Brigada e Parë Maqedono – Kosovare, e formuar më 11.XI.1943 në fshatin Slivovë të Maqedonisë Perëndimore. Në këtë brigadë pati edhe shqiptarë nga viset ku ajo u formua. Ajo qysh më 3.XII.1943 u ndesh me forcat patriotike të Xhemë Gostivarit afër Debarcës dhe pas disfatës që pësoi u detyrua të kalojë në Greqi për t'i konsoliduar radhët. Shqiptarë të shumtë pati edhe në Brigadën VIII të Preshevës e cila u formua në fillim të muajit gusht të vitit 1944 në fshatin Ramno. Kjo brigadë kishte tri batalione.

Njësitet e llojllojshme të formuara të UNÇ e AP për Kosovë e Metohi luftonin si pushtuesin nazifashist ashtu edhe të gjithë organizmat kombëtarë shqiptarë. Për këtë arsye në shënjestër të tyre u futën njësitet e armatosura dhe të paarmatosura të qeverisë shqiptare, si dhe organizmat e tjerë kombëtarë (Lidhja e Dytë e Prizrenit, njësitet e armatosura vullnetare etj.). Veprimtaria luftarake e këtyre njësiteve ishte e përqendruar kryesisht në viset etnike shqiptare apo të përziera me shqiptarë. Kështu, çeta partizane “Bajram Curri” në bashkëveprim me afro 200 fshatarë të Malësisë dhe forcat e vëllezërve Kryeziu më 10 – 12.IX.1943 luftoi për “çlirimin” e Gjakovës. Pas “çlirimit” të Gjakovës ato filluan luftimet kundër forcave të vogla gjermane, mirëpo nga KK i PKJ-së kjo luftë u vlerësua si oportuniste, pasi njërën anë të qytetit e mbanin forcat e UNÇJ-së, kurse tjetrën gjermanët. Për “çlirimin” e këtij qyteti u vranë 3 gjermanë, një numër ushtarësh dhe oficerësh italianë, si dhe disa milicë shqiptarë, kurse humbjet e çetës partizane “Bajram Curri” dhe të Çetës Vullnetare ishin të vogla. Pas këtij veprimi çeta “Bajram Curri” me kërkesën e Korparmatës së Dytë të UNÇJ-së shkoi në drejtim të Plavës dhe të Gucisë me qëllim që atje të luftojë kundër “reaksionit”, pra kundër shqiptarëve dhe myslimanëve që luftonin me forcat e UNÇJ-së dhe me çetnikët e llojllojshëm. Në ndërkohë (nëntor 1943) LNÇ me ndihmën e kuadrove të dërguara nga organizata e Partisë e Shkodrës po forcohej edhe në këto rajone dhe kishte formuar edhe njësitet e veta të armatosura. Mirëpo, krijimi i këtyre forcave nuk kishte ndikim të ndjeshëm, pasi ato nuk përpqeshin për sendërtimin e dëshirave të ligjshme të popullit të vet, por për forcimin e lidhjeve “vëllazërore” me njësitet malazeze, që synonin në radhë të parë të shpartallonin përpjekjet e forcave patriotike shqiptare për mbrojtjen e viseve të tyre etnike. Kjo ishte edhe arsyeja që Ramë Muja të kërkonte largimin e njësiteve të UNÇSH-së e të UNÇJ-së nga këto anë, ngase ato, siç mendonte edhe populli shqiptar i Plavës dhe i Gucisë, në vend të shkabës mbanin yllin partizan.

Para se të shkojë në Plavë dhe Guci çeta partizane “Bajram Curri” u kthye në Malësi të Gjakovës dhe siguroi Konferencën e Bujanit, por më 14.II.1944 Malësia e Gjakovës u sulmua nga 1.200 ushtarë gjermanë dhe 800 vullnetarë. Luftimet zgjatën 12 orë dhe me atë rast u vranë ose u

plagosën 11, si dhe u zunë rob afro 50 partizanë. Aradha “Curri – Rexhepi” u shpartallua, por nuk u kap SHK i UNÇ e AP për Kosovë e Metohi që gjendej në këtë terren. Nuk vonoi shumë dhe aradha e përmendur u përtëri. Më 30.IV.1944 një njësit i aradhes “Bajram Curri – Perlat Rexhepi” në mbrëmje preu shtyllat e telefonit në rrugën Pejë – Gjakovë dhe ia dha flakën një kamioni gjerman. Po atë ditë njësit tjetër i po kësaj aradhe preu shtyllat e telefonit në rrugën Prizren – Gjakovë, kurse njësit që vepronte në Has ndezi ndërtesën e komunës dhe vrau kryetarin e saj në Zym Ramë Malokun, si dhe agentin Ali Vokshi. Në gjysmën e dytë të vitit 1944 batalioni “Kosova” në rajonin Prizren – Kukës, pastaj afër Bytyçit, Junikut dhe Tropojës, si dhe në territorin e Pejës, Plavës dhe të Gucisë sulmoi disa herë kolonat e motorizuara të pushtesve gjermanë. Po kështu u veprua edhe në shtator të këtij viti në rrugën Prizren – Kukës.

Injorimi i shqiptarëve dhe formimi i Brigadës Shqiptare në Maqedoni

Veprimet e njësiteve të armatosura jugosllave e shqiptare të quajtura partizane në fund të vitit 1943 zhvilloheshin edhe në Maqedoninë Perëndimore. Më 1.XI.1943 njësitet e grupeve të batalioneve “Mirçe Acev”, “Boris Vukmirovic”, “Ramiz Sadiku”, batalionet e rinisë së Kërçovës dhe të Dibrës dhe një batalion shqiptar i këtij rrethi sulmuan Kërçovën. Pala kundërshtarë pati 4 të vranë dhe 18 ushtarë e oficerë gjermanë të zënë rob, si dhe 30 bashkëpunëtorë të gjermanëve. U sekuestruan 8 mitraloza dhe 4 automjete të ndryshme. Në këtë luftë u zu rob edhe oficeri gjerman Hedler. Gjermanët dhe bashkëpunëtorët e tyre u tërhoqën në Zajaz e në male të Bukovikut dhe në drejtim të Gostivarit e të Tetovës. Nuk vonoi shumë dhe më 11.XI.1943 njësitet partizane të komanduara nga Hamdi Dema dhe Qemal Agolli “çliruan” një pjesë të Gostivarit, kur strukturat politike e ushtarake maqedonase bënë plane për marrjen e pushtetit pa i llogaritur fare shqiptarët si subjekt i rëndësishëm i kësaj treve.

Injorimi i shqiptarëve në Maqedoni u pa edhe në mbledhjen e parë të Këshillit të Zgjeruar Iniciativ për thirrjen e Kuvendit Antifashist të Këshillit Nacionalçlirimtar të Maqedonisë më 30.IV.1944, në të cilin nuk u parapa asnjë shqiptar edhe pse lufta zhvillohej në viset e tyre dhe në të merrnin pjesë edhe shumë shqiptarë. Po kështu ndodhi edhe në mbledhjen e parë të formimit të këtij organi më 2.VIII.1944, në të cilën në mënyrë simbolike morën pjesë Kemal Agolli, student i filozofisë nga Dibra, Nafi Sylejmani, bujk nga Manastiri, Kamber Hasani, bujk nga Dolno Disane i Kavadarit dhe njëfarë Abdullahu nga Presheva. Edhe zgjedhja në këtë organ të lartë u bë në

mënyrë simbolike dhe prej 17 anëtarëve, sa ishin përfshirë në të, u zgjodhën vetëm dy shqiptarë (Qemal Agolli dhe Kamber Hasani). E njëjtë ishte edhe gjendja në forcat e armatosura të UNÇ të Maqedonisë dhe nga 10 anëtarë të SHS të UNÇ-së e AP-së për Maqedoni prej shqiptarëve ishte vetëm Hamdi Dema (kapiten i Ushtrisë Shqiptare nga Dibra). Kjo ishte arsyeja që ishin të kota ftesat që i bëheshin popullit shqiptar dhe atuj turk për pjesëmarrje në luftën e ashtuquajtur nacionalçlirimtare. Në asnjë nga dokumentet e miratuara nga organi më i lartë i përmendur shqiptarëve dhe turqve nuk u garantohej asgjë. Mirëpo, për disa shqiptarë të Maqedonisë Perëndimore as kjo nuk ishte mësim dhe më 10.XI.1944 në Karaorman u formua Brigada IV Shqiptare, e cila më vonë u riemërua si Brigada VII Sulmuese Shqiptare. Në fillim kjo kishte 450 luftëtarë, por brenda një kohe të shkurtër u rrit në 500 luftëtarë. Komandant i saj u zgjodh Nafi Sylejmani. Më 19.XI.1944 kjo brigadë dhe disa njësite të tjera maqedonase rrethuan qytetin e Kërçovës, por pas luftimeve të rrepta të zhvilluara pranë fshatit Bileçicë kundër forcave vullnetare të Aqif Reçanit u detyruan të tërhiqeshin. Në këto rrethana shumë shqiptarë u demoralizuan dhe kaluan në anën e forcave të Xhemë Gostivarit. Vetëm pas dy dite forcat e Xhemës dhe të Mefail Zajazit, që arritën në mbi 1.000 vetë morën kontrollin në Kërçovë dhe gati në tërë Maqedoninë Perëndimore. Ata detyruan ushtrinë italiane të dorëzonte teknikën ushtarake të Hanet e Mavrovës. Me angazhimin e forcave patriotike e partizane shqiptare u “çliruan” qytetet kryesore të Maqedonisë Perëndimore. Në atë kohë në Prespë e rrethinë, që deri atëherë ishte nën sundimin italian, hynë njësitet pushtuese bullgare, të cilat pushkatuan 30 vetë, pjesa dërmuese e të cilëve ishin shqiptarë. Shumë banorë të Nakolecit, Kranjës, Shtërbovës dhe të disa fshatrave të tjera ishin të gatshëm të hidheshin në kryengritje. Madje, një grup prej 70 vullnetarësh kaloi nga këto anë në Shqipëri ku u bashkua me njësitet partizane. Çlirimi i këtyre trojeve dhe krijimi i zonave të lira, që ishin të vetmet në gjithë territorin e Maqedonisë, që nga shtatori deri në mesin e nëntorit 1943, në radhë të parë ishte rezultat i luftës dhe i përpjekjeve të popullit shqiptar, që përbënte shumicën dërmuese të popullsisë së këtyre viseve. Ky territor u bë mbështetje e LNÇ-së në viset etnike shqiptare në Maqedoni, ku u formuan njësite të reja partizane.

Ripushtimi i i Kosovës

Në pranverë të vitit 1944, për shkak të rrethanave në frontet e luftës në botë dhe të zhvillimit të vetë LNÇ-së në Jugosllavi dhe në Shqipëri, UNÇJ kaloi në ofensivë në të gjitha vendet. Në vjeshtë të vitit 1944 forcat kryesore ishin orientuar në këto anë, sepse ato në këtë kohë kishin rëndësi vendimtare

si në aspektin ushtarak ashtu edhe në atë politik. Në këtë kohë u rrezikua pozita e grupit gjerman të armatave "E" në Greqi, kështu që ajo u detyrua të tërhiqej nëpër Maqedoni, Kosovë, Sanxhak, Mal të Zi dhe Bosnjë. Po kështu KAÇKJ ishte marrë vesh me Moskën për pjesëmarrjen e Armatës së Kuqe në operacionet ushtarake në Jugosllavi dhe me Frontin Patriotik të Bullgarisë që në luftimet kundër forcave gjermane të mermin pjesë edhe forcat bullgare. SHS i UNÇJ-së u mor vesh edhe me SHK të UNÇSH-së që njësitet e saj të mermin pjesë në po këto operacione ushtarake. Pas këtyre marrëveshjeve filluan luftimet për kinse çlirimin e Kosovës dhe të viseve të tjera etnike shqiptare, por në të vërtetë ishte fjala për ripushtimin klasik të tyre.

Forcat e UNÇSH-së ishin të parat që hynë në territorin e Kosovës. Kjo ndodhi pasi më 1. IX.1944 komandanti suprem i UNÇ-sjë e APJ-së i dërgoi depeshë UNÇ-së e AP të Shqipërisë që të kalojë në Kosovë e në vise të tjera të Jugosllavisë. Më 13.X.1944 pjesë të Divizionit V të UNÇSH-së të Gjakova kapërcyen kufirin "shqiptaro – jugosllav". Po në këtë kohë në Kosovë hynë edhe forcat e Brigadës IV të UNÇ-së e AP-së për Kosovë e Metohi. Më 17.X.1944 Armata II Bullgare u nis për në Kosovë. Ajo shoqërohej nga njësitet e Korpusit të 13-të të UNÇJ-së dhe nga njësitet e SHO të UNÇ-së e AP-së për Kosovë e Metohi.

Në ndërkohë kishin filluar lëvizjet edhe në radhët e ushtrisë gjermane. Shtabi i grupit të armatave "E" kaloi më 14.X.1944 nga Selaniku në Stari Tërg afër Mitrovicës. Prej këtu ai udhëhiqte drejtpërdrejt tërheqjen e forcave gjermane nëpër Kosovë. Ai mori masa për sigurimin e krahut të djathtë dhe të majtë dhe për këtë qëllim formoi dy grupe luftarake: grupin "Langer", i cili kishte për detyrë ta merrte Kurshumlinë dhe ta mbyllte drejtimin kah Podujeva, dhe grupin "Bredo", i cili kishte për detyrë ta mbyllte drejtimin Bujanoc – Gjiilan – Prishtinë. Afro 6.000 vullnetarë, të cilët gjendeshin midis këtyre dy grupeve mbyllën vijën Bujanovc – Kitkë – Maja e Markut – Merdar – Përpellac – Kërshi i Uglarit. Forcat të cilat e bënë sigurimin në drejtim të lindjes formuan grupin ushtarak "Sholc". Grupi "Skenderbeg" mbante kryesisht Pejën, Gjakovën dhe Prizrenin, duke siguruar krahun e majtë të grupit të armatave "E" dhe depotë e Korparmatës së 21-të Malore në Prizren. Pasi këtyre forcave u kërcënohej rreziku dhe për shkak se në Përpellac ishte vetëm një battalion, u dërguan përforcime, kurse me aeroplanë në Prishtinë u bart një pjesë e Divizionit sulmues "Rodos". Me kalimin e kohës në këtë territor u vendosën e u zhvendosën edhe forca të tjera të pushtuesve gjermanë, por edhe u formuan formacione të reja ("Shuster – vodau" p.sh.), kështu që në Kosovë dhe në kufijtë e saj brenda një muaji u përqendruan shumë forca të armatosura dhe u zhvilluan luftime të rrepta me pasoja si në njerëz ashtu edhe në të mira materiale.

Planin për *Operacionin e Kosovës* që filloi më 23.X.1944 e bëri Shtabi Operativ i UNÇ-së e AP-së për Kosovë e Metohi, pasi SHS u UNÇ e APJ-së e degradoi atë më 2.IX.1944 nga Shtabi Kryesor, i cili më 14.IX.1944 iu nënshtrua SHK të UNÇ e AP për Serbi. Megjithatë, SHS i UNÇ e APJ-së lejoi që edhe më tej të mbeten dy zona operative të këtij shtabi. Po në këtë kohë SHS i UNÇ e APJ-së urdhëroi forcat e UNÇ të Kosovës të depërtonin në Kosovë, sikurse që duhej këtë ta bënin edhe forcat UNÇ të Maqedonisë. Në këtë mënyrë filloi *Operacioni i Kosovës* me njësitet e Korpusit të 13-të të UNÇJ-së (Divizioni i 22-të, i 24-të dhe i 46-të serb), me të gjitha brigadat e UNÇ-së e AP-së për Kosovë e Metohi, me njësitet bullgare të Armatës II; me forcat e UNÇSH-së, si dhe me forcat e UNÇ të Maqedonisë (Divizioni i 41-të maqedon, i cili u formua më 25.VIII.1944 nga Brigadat II, IX, X dhe XI maqedone). Ky operacion filloi me sulmet e forcave të përmendura në tri drejtime: Kurshumli – Përpellac – Podujevë – Prishtinë; Lebane – Medvegjë – Prishtinë dhe Bujanoc – Gjilan – Prishtinë. Në arsyetimin për këtë ndërmarrje me këto përmasa SHS i UNÇ-së e AP të Jugosllavisë theksonte se kjo bëhej jo vetëm për shkatërrimin e pushtuesve gjermanë, por para së gjithash për shkatërrimin e “reaksionit” të madh që mbretëronte në Kosovë. Se ishte kështu pajtohej plotësisht edhe sekretari i KQ të PKSH-së, Enver Hoxha, i cili qysh më 10.IV.1944 i dërgoi letër KK të PKJ-së për Kosovë e Metohi, në të cilën thuhej se “situata në Kosovë ishte e vështirë dhe ajo ishte qendër e reaksionit të Shqipërisë dhe të Jugosllavisë”, prandaj kërkonte zhveshjen e tyre dhe diferencimin nga elementët e luhatshëm. Po këto mendime i përsëriti edhe Josip Broz Tito në letrën që ia dërgoi SHK të UNÇSH-së më 1.IX.1944.

Për depërtim në drejtimin Kurshumli – Podujevë – Prishtinë me qëllim pushtimi të Podujevës me rrethinë ishin angazhuar Armata II bullgare (pa Divizionin e 12-të të Këmbëorisë dhe pa Divizionin e 2-të të Kalorësisë) dhe Divizioni i 24-të dhe i 46-të serb. Divizioni i 24-të serb (pa Brigadën XVII) do të depërtonte në krahun e djathtë të Armatës II bullgare në drejtimin Kërtingjak – Sllatinë – Pollatë – Kaçanoll – Bajgorë dhe do të merrte Mitrovicën e Vushtrinë për ta ndërprerë linjën e qarkullimit Prishtinë – Mitrovicë. Divizioni i 12-të bullgar i Këmbëorisë dhe Brigada V e UNÇ e AP për Kosovë e Metohi duhej të depërtonin nga Lebane nëpër Medvegjë e të hynin në Prishtinë, kurse Divizioni i 2-të i Kalorësisë dhe pjesë të Divizionit të 46-të serb do të hynin në Bujanoc e pastaj të depërtonin në Gjilan e në drejtim të Prishtinës. Ishte paraparë që Brigada II dhe III e UNÇ e AP për Kosovë e Metohi të vepronin në jug të Bujanocit e pastaj në afërsi të Ferizajt.

Brigadat I dhe IV UNÇ e AP për Kosovë e Metohi dhe Brigadat III dhe V të UNÇSH-së ishin paraparë të luftonin në Dukagjin. Këto brigada

zhvilluan luftime të rrepta kundër njësiteve të grupit luftarak “Skenderbeu” dhe forcave të shumta vullnetare. Në rrugën Prizren – Shkodër dhe Prizren – Deçan ato luftuan kundër forcave gjermane, të cilat tërhiqeshin nga Shqipëria dhe siguronin krahun e majtë të grupit të armatave “E”, kurse në fshatra dhe në Gjakovë kundër vullnetarëve. Brigada I e UNÇ e AP për Kosovë e Metohi dhe Brigada III e UNÇSH-së vepronin në drejtim të Deçanit dhe të Pejës, kurse Brigada IV e UNÇ e AP për Kosovë e Metohi dhe Brigada V e UNÇSH-së në drejtim të Prizrenit. Njësitet të cilat depërtonin në drejtim të Dragashit, Gjakovës, Prizrenit e Pejës “çliruan” së pari Dragashin më 5.X.1944, pastaj Hasin, kurse më 14.X.1944 sulmuan Gjakovën. Këtë qytet e sulmuan Brigada IV e UNÇ e AP për Kosovë e Metohi dhe Brigada V e UNÇSH-së, të cilat u shkatuan dëme të konsiderueshme forcave gjermane dhe vullnetare, mirëpo qytetin nuk e morën për shkak se njësiteve kundërshtare u erdhën në ndihmë forca nga Prizreni e Peja. Luftimet vazhduan, ndërsa ishin të rrepta në Batushë, Junik dhe Deçan. Së pari u ripushtua Gjakova, më 9.XI.1944, e pastaj Prizreni, Peja dhe Istogu më 19.XI.1944, kurse Rahoveci më 17.XI.1944. Duhet shtuar se në këto luftime pati edhe forca të Brigadës XVIII të UNÇ të Serbisë.

Luftimet për Rrafshin e Kosovës filluan që nga ditët e para të nëntorit të vitit 1944. Përballë forcave gjermane dhe vullnetare në rajonin e Orllanit dhe të Podujevës ishin forcat e disa njësiteve të Armatës II bullgare, Brigada V e UNÇ e AP për Kosovë e Metohi dhe Brigada XVII e Divizionit të 24-të serb. Podujeva u sulmua më 4.XI. nga njësitet e Brigadës V të UNÇ e AP për Kosovë e Metohi dhe nga një pjesë e batalionit “Meto Bajraktari”, ndërsa luftimet vazhduan deri më 15.XI. kur nga kjo anë u tërhoqën forcat gjermane. Në këto luftime u angazhuan Divizioni i 4-të, i 9-të dhe i 12-të i Armatës II bullgare, si dhe një njësit tankist i kësaj armate. Podujeva u ripushtua më 8.XI. Brigada XXV e Divizionit të 46-të serb, Brigada II dhe III e UNÇ e AP të Kosovë e Metohisë dhe një pjesë e Divizionit të 2-të të Kavalerisë së Armatës II bullgare më 16.XI. ripushtuan Gjilanin, Kaçanikun, Vitinë dhe Novobërdën. Luftime të rrepta e me humbje të dyanshme u zhvilluan në rrugën Gjilan – Prishtinë, si dhe në Gjilan që u sulmua nga forcat vullnetare. Një ditë më vonë, më 17.XI. nga njësitet e Brigadës II të UNÇ e AP për Kosovë e Metohi dhe njësitet e Armatës II bullgare u ripushtua edhe Ferizaj. Në këto veprime luftarake mori pjesë edhe Batalioni i Rakoshit me 250 luftëtarë. Po në këtë kohë në Siriniqu depërtuan edhe disa njësite të Brigadës II të UNÇ e AP për Kosovë e Metohi. Lipjani u ripushtua më 18.XI. nga forcat e Brigadës XXV të UNÇ e AP për Serbi, ndërsa po këto forca më 19.XI. hynë edhe në Prishtinë. Po atë ditë në këtë qytet hynë edhe forcat e Brigadës V të UNÇ e AP për Kosovë e Metohi dhe

një pjesë e batalionit “Meto Bajraktari”. Vushtrrinë e ripushtoi Brigada VIII e Divizionit të 22-të serb, ndërsa Brigada X e Divizionit të 22-të serb me njësitet e APNÇ të Shalës më 22.XI. hynë në Stari Tërg. Mitrovica dhe Zveçani u “çliruan” nga forcat e Divizionit të 22-të serb dhe nga Brigada Tankiste Bullgare. Në këtë mënyrë u “çlirua”, përkatësisht u pushtua e tërë Kosova dhe ranë në ujë të gjitha premtimet që PKJ e PKSH i dhanë popullit shqiptar për çlirimin e tij kombëtar e demokratik.

Pasi këtyre premtimeve nuk u besonte kurrë populli shqiptar, shumë nga pjesëtarët e tij u mobilizuan dhe iu kundërvunë depërtimit të këtyre forcave në Kosovë. Në anën e Llapit dhe të Shalës, veç vullnetarëve, kundër forcave të UNÇJ-së luftonin Regjimenti IV i Ushtrisë Shqiptare me rreth 2.500 – 3.000 luftëtarë, pjesë të Divizionit XXI SS “Skenderbeg” dhe Batalioni i Rinisë për Mbrojtjen e Kosovës. Në këtë kohë u zhvilluan luftime të rrepta me humbje të konsiderueshme të të dy palëve. Komandant i forcave shqiptare në anën e Llapit ishte Jahja Fusha, të cilit më 9.IX. 1944 gjermanët ia dorëzuan pushtetin e nënprefekturës së Podujevës, por si komandantë u dalluan edhe Musli Dumoshi, mulla Demë Pakashtica, Ukë Mavriqi e të tjerë. Luftime të përgjakshme u zhvilluan përgjatë gjithë kufirit, por u shquan ato në Peci, ku sulmuan Brigada XI e XIII të UNÇJ-së. Në këtë betejë pati shumë të vrarë nga të dy palët. Luftimet ishin të rrepta edhe në Përmalinë të Llapit dhe në Shalë më 24 – 28.X. 1944 kur Divizioni XXIV i UNÇJ-së depërtoi në vijën e frontit në jug të Gurit të Uglarit dhe pushtoi fshatrat veriorë të Llapit. Pasi ky divizion depërtoi në vijën Pakashticë – Kaçanoll – Maja e Mprehtë, vullnetarët shqiptarë, Brigada e Ukshin Kovaçicës, batalioni “Hasan Prishtina” dhe një grup i luftëtarëve me Aziz Zhilivodën kaluan në sulm dhe shkatërruan forcat e UNÇJ-së. Luftëra të përgjakshme u zhvilluan në Kaçanoll dhe Dobratin. Divizioni XXIV i UNÇJ-së pothuajse u shkatërrua i tëri duke iu vrarë 389 luftëtarë. Këtë e zëvendësoi Divizioni XXII i UNÇJ-së. Po në këtë kohë luftime zhvilloheshin në drejtim të Serbisë fare në veri të Kosovës të udhëhequra nga Ahmet Selaci, ndërsa në Gallup për luftime u shqua Hakif Rimanishta me forcat e tij.

Ripushtimi i viseve të tjera etnike

Në luftimet për dëbimin e forcave gjermane nga Struga morën pjesë Brigada XX e UNÇSH dhe Brigada IV e UNÇ e AP për Maqedoni. Në prag të këtij veprimi forcat patriotike të komanduara nga Nazim Tateshi, Faik Dobovjani dhe Murat Labunishte ofruan bashkëpunim, por komanda maqedonase nuk pranoi, prandaj ata u zunë dhe iu dorëzuan organeve të

ndjekjes e të hetuesisë dhe u ekzekutuan me procedurë të shpejtë. Struga u “çlirua” nga gjermanët më 9.IX.1944. Në luftimet për “çlirimin” e Kërçovës morën pjesë njësitet maqedonase (Brigada I, VI e XV), Brigada IV Shqiptare e Maqedonisë dhe njësitet e UNÇSH-së (Batalioni i 4-të i Brigadës XVIII), mirëpo i tërë populli i kësaj ane nën udhëheqjen e Xhemë Gostivarit dhe Mufail Zajazit u ngrit kundër tyre dhe i theu keq. Aty u dërgua Brigada IV Shqiptare e Maqedonisë, e cila i shpëtoi brigadat e përmendura maqedonase nga shpartallimi i plotë. Duke ndeshur në qëndresën e vendosur shqiptare, SHK i UNÇ e AP për Maqedoni për tejkalimin e situatës së krijuar dhe që ta merrte Kërçovën me ndihmën e Brigadës IV Shqiptare, dërgoi Qemal Agollin për të biseduar me parinë e vendit dhe me organizatën partiake të Kërçovës. U arrit marrëveshja që në qytet të hynte vetëm Brigada IV Shqiptare e Maqedonisë. Popullsia e fshatrave përreth, duke mos ditur për marrëveshje, kishte vazhduar qëndresën kundër brigadave maqedonase. Luftime të rrepta u zhvilluan sidomos në afërsi të fshatit Zajaz, kur Brigada XV pësoi humbje të mëdha dhe ndoshta do të shpartallohej plotësisht po të mos ndërmjetësonte sërish Brigada IV Shqiptare e Maqedonisë. Pas “çlirimit” të Kërçovës, Brigada IV Shqiptare duhej të angazhohej për marrjen e Gostivarit. Mirëpo, këtë ide e kundërshtonte Komanda e Divizionit të 48-të maqedonas. Ajo ngulte këmbë që këtë veprim ta kryenin formacionet e saj, sepse në këtë mënyrë do t’i kishte duart e lira për eliminimin e shqiptarëve nga trevat e tyre etnike. SHK i UNÇ e AP për Maqedoni nga droja e vendosmërisë shqiptare vendosi që për këtë qëllim të përdoreshin njësitet e Brigadës IV Shqiptare dhe njësitet e batalionit “Nazmi Rushiti”. Ky batalion gjatë rrugës, në Rekën e Epërme dhe të Poshtme, u ndesh me forcat e Ali Tërnicës dhe të Shemsi Habibit dhe zbriti në Mavrovë e pastaj në Reçan e Vërtok, ku u bashkua me Brigadën IV Shqiptare. Prej andej këto forca më 18.XI.1944 hynë në Gostivar. Mirëpo, SHK i UNÇ e AP për Maqedoni urdhëroi që Brigada IV Shqiptare dhe batalioni “Nazmi Rushiti” të largoheshin nga Gostivari dhe në vend të tyre të vendoseshin forcat maqedonase. Në këtë qytet u vendos edhe SHK i UNÇ e AP për Maqedoni.

Në mesin e nëntorit 1944 me nismën e antifashistëve dhe të patriotëve shqiptarë popullsia shqiptare e Tetovës organizoi kryengritjen në qytet, arrestoi ata që kishin bashkëpunuar me pushtuesin, çarmatosi policinë dhe më 16.XI.1944 pushtetin e mori KNÇ. Edhe këtu u dërgua Brigada IV Shqiptare e Maqedonisë, mirëpo prania e saj pengonte qarqet shoviniste maqedone që synonin zbatimin e dhunës dhe të terrorit, prandaj SHK i UNÇ e AP për Maqedoni urdhëroi që kjo brigadë të largohej nga Tetova dhe të shkonte në drejtim të Shkupit për të ndihmuar sikurse edhe deri atëherë në nënshtrimin e fshatrave shqiptare në rrethinën e tij deri në Kumanovë,

Preshevë e Gjilan. Në të vërtetë, në Shkup që nga tërheqja e forcave bullgare (9.IX.1944) filloi të organizohej pushteti demokratik shqiptar dhe forcat e tyre të armatosura të udhëhequra nga Halim Rainca – Karadaku. Ndërkohë rreth Karadakut të Shkupit u përqendruan njësitet ushtarake maqedonase, veprimtaria e të cilave u shqua me masat e njohura antishqiptare. Kjo politikë u bë shkak i përlëshjeve me armë midis këtyre dy palëve. Forcat maqedonase ishin të shumta dhe në Saraj u arrit marrëveshja që ato të hynin në Shkup, por pa u cënuar askush, përveç atyre që kishin bërë krime. Kështu nuk ndodhi dhe me të hyrë të këtyre forcave në Shkup filluan dhuna, terrori dhe raprezaliet kundër popullit shqiptar. Nuk vonoi shumë dhe kështu do ta përjetonin edhe viset e tjera etnike shqiptare në Maqedoninë Perëndimore. SHK i UNÇ e AP për Maqedoni i dha urdhër Korparmatës IV të UNÇ e AP për Maqedoni të fillonte “spastrimin e zonës Kërçovë – Tetovë – Gostivar”. Në këtë kohë u ndërpre edhe qëndresa frontale nën komandën e Xhemë Gostivarit. Në takimin që pati ai me përfaqësuesit e UNÇSH-së në fshatin Reç të Rekës së Epërme, kërkoi që nga këto njësite të pranoheshin në radhët e UNÇSH-së së paku ushtarët e tij, gjë që u kundërshtua dhe Xhema pasi shpërndau ushtrinë u strehua në fshatin Gorjan. Më pas OZN-a me ndihmën e agjentëve të vet arriti ta helmojë atë, ndërsa bashkëluftëtarët e tij që u dorëzuan u likuiduan në mënyrën më barbare dhe pa gjyq.

Në ripushtimin e Bujanocit dhe të Preshevës më 1944, përkatësisht të vijës kufitare Kumanovë – Bujanoc të gjatë afro 35 km. morën pjesë afro 10.000 bullgarë dhe forca partizane serbe e maqedonase, të ndara në 13 brigada të UNÇJ-së. Përballë tyre u vunë forcat vullnetare shqiptare të udhëhequra nga KRNMK. Forcat e këtij komiteti ishin të vogla (prej 150 deri në 200 vetë), por paraqisnin bërthamën e mobilizimit të shqiptarëve vullnetarë të kësaj ane. Për sendërtimin e këtij qëllimi u formua edhe komiteti i këtij organi nën udhëheqjen e kolonel Fuad Dibrës dhe të kapiten Bajram Hoxhës. Mirëpo, ky komitet u formua shumë vonë, përkatësisht në kohën e zhvillimit të luftimeve të rrepta, kështu që nuk u arrit të organizohej ashtu si duhej, prandaj në krye të njësiteve të armatosura nuk u zgjodhën as komandantët për udhëheqjen e luftës. Megjithatë, në luftën mbrojtëse u dalluan dhe morën barrën Sylë Hotla, Ajet Rainca, Musa Mustafa, Abdyl Durra, Hasan Remniku, Hasan Kabashi, mulla Jusuf Kaçaniku, Ibrahim Kelmendi, Ali Sylja, Jusuf Lipovica etj. Disa prej këtyre personaliteteve (p.sh. mulla Jusuf Kaçaniku, Abdyl Durra, Ramiz Cërmica, Adem Stançiqi) pas depërtimit dhe nënshtrimit të viseve shqiptare nga ana e njësiteve të UNÇJ-së dhe të njësiteve bullgare vepruan mbështetur në rrethanat e krjuara dhe ndikuan në inkuadrimin e shqiptarëve në njësitet e UNÇJ-së, veçanërisht në Brigadën VII të UNÇ e AP për Kosovë e Metohi, e njohur edhe si brigada e Shaban Haxhisë. Pjesa tjetër e udhëheqësve të shqiptarëve

nuk u pajtuan me këto rrjedha dhe vazhduan qëndresën e armatosur. Kështu nuk veproi as prefekti i Preshevës Mustafa Natiku, i cili pranoi që nëpër Preshevë të “kalonin” forcat bullgare. Me palën e udhëheqësve shqiptarë që nuk dëshironin t’u nënshtroheshin këreksave partizane, pasi nëpërmjet Sylejman Veliut iu dërgua një letër, më 12.XI.1944, biseduan delegacionet me në krye Abdullah Krashnicën, përfqësues i palës partizane dhe Ibrahim Kelmendin, përfaqësues i shqiptarëve të patundur. Bisedimet përfunduan pa sukses ngase pala e Ibrahim Kelmendit theksoi se armët nuk mund të dorëzoheshin pa u pa statusi dhe gjendja e Kosovës. Për rrjedhojë filluan luftimet e rrepta.

Luftimet e rrepta e të pandërprera të vullnetarëve shqiptarë dhe të njësiteve bullgare e të UNÇJ-së në këto anë filluan më 19.IX.1944 dhe zgjatën deri më 14.XI.1944. Në anën e njësiteve të UNÇJ-së dhe atyre bullgare ishin afro 10.000 ushtarë të përgatitur e të armatosur madje edhe me topa e tanke, ndërsa në anën e shqiptarëve numri i tyre ishte shumëherë më i vogël, por që ndryshonte falë vullnetarëve të fshatrave përreth. Veç kësaj, shqiptarët ishin të përgatitur e të armatosur shumë dobët (kishte raste kur luftonin edhe me sëpata), mirëpo i mbante dëshira për çlirim dhe lufta e pakompromis kundër ripushtimit. Kjo ishte arsyeja që forcat ripushtuese pësuan humbje të mëdha dhe në këto luftime, sipas pohimeve të të dëmtuarve, humbjet e bullgarëve dhe të UNÇJ-së ishin afro 3.000 ushtarë. Luftohej të thuash për secilin fshat e pozicion, mirëpo u dalluan luftimet në Guri të Zi, Ramë, Villaj Grob, Tanushec, Rexhep Han, Nesalcë. Në Përroin e Rincës forcat partizane humbën afro 500 luftëtarë dhe në këtë mënyrë ky përreu u bë njëfarë Thermopileje e shek. XX. Njësitet bullgare dhe të UNÇJ-së për të mashtruar shqiptarët disa herë shpërndanë me aeroplanë afishe në gjuhën shqipe dhe turke. Në këto afishte Atlante Koçi, deri dje me italianët, nuk ngurronte madje që shqiptarët e Preshevës dhe të Bujanovcit t’i luste për t’iu bashkëngjitur njësiteve të Fadil Hoxhës. Mirëpo, as këto afishe dhe as këto lutje nuk patën efektin e pritur. Vetëm më 27.X.1944 njësitet bullgare në Sopot patën 74 të vrarë. Të tërbuar nga këto humbje ata në këtë fshat pushkatuan 68 fshatarë dhe pushkatimet e masakrimet nuk do t’i kishin të ndalur sikur të mos intervenonte Abdullah Krashinca në cilësinë e njësiteve partizane. Bullgarët humbje të ndjeshme pësuan edhe në luftimet me shqiptarë në Zhunicë, Miratoc dhe Llojan. Këso humbjes përjetuan njësitet e UNÇJ-së në luftimet në Muçibabë, të udhëhequra nga Ymer Muçibaba. Ndonëse njësitet e tij ishin simbolike (afro 120 vetë), partizanët u detyruan disa herë të zbrapseshin në drejtim të Pisjanit. Të tmerruar nga qëndresa e shqiptarëve në fshatin Runicë, por edhe për shkak të humbjeve të tyre, partizanët edhe në këtë fshat pushkatuan dhjetëra njerëz, si dhe dogjën shumë shtëpi dhe 3-4 fëmijë të vegjël. Më në fund, falë forcave të shumta

ushtarake dhe armatimit të tyre mjaft të përsosur bullgarët hynë në Preshevë më 14.XI.1944, kurse forcat serbe e malazeze, të shoqëruara nga maqedonasit dhe disa shqiptarë, këtë qendër e ripushtuan vetëm më 16.XI.1944. Ky ripushtim si përherë në histori u karakterizua me vrasje, pushkatime e masakra të llojllojshme, të cilat vazhduan edhe në muajin dhjetor të vitit 1944, por edhe gjatë vitit 1945.

Ripushtimi i viseve etnike shqiptare në Mal të Zi filloi në gjysmën e vitit 1944. Brigada IX malazeze duke bashkëvepruar me “njësitet e komëve” dhe partizanët vendës zuri rrugën Murinë – Pejë. Këto forca më 11.XI.1944 “çliruan” Gucinë, kurse më 16.XI.1944 Plavën. Këtyre në Vuthaj u erdhi në dihmë Batalioni i 3-të i Brigadës XXV të UNÇSH-së, i cili zuri rob krerët e forcave patriotike të Plavës dhe të Gucisë me në krye Shaban bej Rexhepagiqin dhe të nesërmen i pushkatoi në Zall të Koçisë (në Krushevë), si dhe mobilizoi të gjithë meshkujt e aftë për pushkë. Njësitet e Brigadës I të Bokës së Kotorrit, duke ndjekur forcat gjermane që po tërhiqeshin, më 24. XI “çliruan” Tivarin, ndërsa më 26.XI.1944 Ulqinin dhe viset e tjera në kufi me Shqipërinë e vitit 1913, me çka u ripushtua përfundimisht Boka dhe bregdeti i Malit të Zi. Pas kësaj, nën preteksin e ndjekjes së forcave “reaksionare” të Hasan Isufit u shpall shtetrrethimi dhe gjendja e jashtëzakonshme, e cila u shoqërua me terror dhe gjenocid.

Me këmbënguljen e palës jugosllave, divizionet V dhe VI të UNÇ e AP të Shqipërisë u angazhuan në luftimet kundër forcave gjermane në Sanxhak, Mal të Zi dhe në Bosnjën Lindore. Këto luftime filluan më 12.XI.1944 dhe ndihmuan për ripushtimin e Tuzit (12.XI.1944), Tutinit, Pazarit të Ri (30.XI.1944, ku morën pjesë edhe njësitet e Brigadës VI serbe), Senicës, Prijepoles, Podgoricës, Pribojit dhe Vishegradit.

Masakrat gjatë luftimeve përfundimtare

Karakteri “çlirimtar” i njësiteve të UNÇJ-së dhe të UNÇ-së në Kosovë dhe në viset e tjera etnike u pa edhe nga qëndrimi dhe veprimi i tyre gjatë luftërave në tetor dhe nëntor të vitit 1944, përkatësisht në luftërat për ripushtimin përfundimtar të këtyre viseve. Grabitjet, vjedhjet, keqtrajtimet, rrahjet dhe vrasjet e shqiptarëve ishin detyrë e këtyre “çlirimtarëve”. Në ditët e para të depërtimit të forcave të UNÇJ-së vetëm në Tauk – Bahçe të Prishtinës u vranë mbi 200 vetë, pjesa dërrmuese shqiptarë, kurse në lumin Klinë dhe në brigjet e tij në fund të vitit 1944 u gjetën 250 shqiptarë të masakruar. Në fshatrat Dërvar, Dobërllukë dhe Këçiç të Vushtrisë gjatë ditëve të fundit të nëntorit 1944 u vranë 22 shqiptarë. Në këto anë dhe në fshatrat përreth Mitrovicës nuk munguan as dhunimet e grave nga ana e

“partizanëve çlirimtarë”. Në ditët e para të çlirimit me e pa gjyq në Pejë dhe në rrugët e saj vriteshin shqiptarë të shumtë, ndërsa vrasja dhe masakrimi i shqiptarëve në rrethin e Kaçanikut ishte bërë dukuri e rëndomtë sa kundër kësaj u detyruan të angazhoheshin edhe pjesëtarët më të devotshëm të LNÇ-së. Veprimet e tilla të bëra edhe me arsyetim se po vriteshin bashkëpunëtorët e armikut dhe po spastrohej terreni prej tyre nuk fsheheshin as në aktet zyrtare të UNÇJ-së, ndërsa për këso veprimesh u caktuan edhe brigada të veçanta, siç ishin p.sh. brigadat XXV, XXVI dhe XXVII të Divizionit të 46-të serb. Detyra të tilla brigadave të veta u caktuan edhe divizionet 22, 41 dhe 42 të UNÇJ-së. Këta të fundit erdhën në Kosovë mu në kohën e “çlirimit” të saj. Hiç më lehtë nuk shpëtuan nga “çlirimtarët” as shqiptarët në Maqedoninë Perëndimore. Gjatë gjysmës së dytë të nëntorit 1944 në rrugët e Gostivarit u vranë shumë shqiptarë duke përfshirë edhe anëtarë të KNÇ të qytetit, si dhe shumë nga ata që kishin ndihmuar LNÇ-në. Më 26.XI.1944 në këtë qytet u pushkatuan mbi 20 shqiptarë të pafajshëm. Masakrat u shtrinë edhe në rrethinën e Gostivarit, si në Vrapçisht, Presk, Zhegër, ku u pushkatuan dhe u therën me bajoneta shumë shqiptarë. Kështu ndodhi edhe në fshatin Zajaz, ku u pushkatuan me dhjetra burra e djem të rinj, ndërsa kazerma e madhe e qytetit u shndërrua në njërin nga burgjet më të tmerrshme, në të cilin të gjithë të burgosurit pa përjashtim moshe e gjinie ishin shqiptarë.

Masakrat në rajonin e Karadakut filluan që herët dhe ato i bënë Brigada VIII e Preshevës, Brigada XII e Bujanocit, Aradha Partizane e Shkupit dhe njësitet e ndryshme bullgare, ndërsa shquhej Brigada XVI Maqedonase. Kjo brigadë më 14.XI.1944 në përëndim të Shkupit, me arsyetim se kishin qenë në shërbim të pushtuesve, likuidoi shumë shqiptarë (sipas disa të dhënave më se 200). Në Bojan ajo likuidoi edhe nga tre meshkuj për çdo shtëpi. Po kjo brigadë më 16.XI.1944 në fshatin Bllacë e Poshtme e Kaçanikut pushkatoi 60 shqiptarë të moshës prej 17 deri në 30 vjeçe. Në këtë fshat u vranë edhe dy fëmijë dhe dy gra. Fushata e egër dhe e terrorit u shtri edhe në rajonin e Kumanovës. Në gusht të vitit 1944 në fshatin Sopot u masakruan 20 burra. Po në atë kohë nga trupat bullgare u masakruan edhe banorët e fshatit Orizare, kurse në tetor të atij viti njësitet e Brigadës XVII maqedonase i vunë zjarrin fshatit Runicë, kurse në nëntor masakruan banorë shqiptarë të fshatrave Izvor dhe Allashec. Për masakrime në Preshevë u dalluan njësitet e Korparmatës së 15-të maqedone, siç ndodhi edhe më 8 e 29.XI.1944 në fshatin Bukurocë e Keqe të rrethit të Preshevës, ku u shua edhe një familje shtatanëtarëshe e Bukurocës. Kështu ndodhi edhe në fshatin Zhegër të Karadakut e Zekbash, ku u vranë e u masakruan me dhjetra shqiptarë. Fshati Iseukë, Hani i Tozes e Monopoli i Duhanit në Preshevë u bënë qendra të ekzekutimeve të shqiptarëve të shumtë nga Presheva dhe

rrethina, nga Malësia e Gjiçanit dhe Malësia e Bujanocit, ndërsa ndër fshatra që përjetuan ekzekutime e keqtrajtime ishin edhe Novosella e Epërme, Zarbica, Muçibaba, Ranatoci, Gosponica, Staneci, Depca, Gurhalija, Burica, Kurbalia, Caravajka, Shurdhani, Seferi etj.

Dr. Izber HOTI

KOSOVA AND OTHER ALBANIAN ETHNIC TERRITORIES FROM ITALY'S CAPITULATION TO THE END OF NOVEMBER 1944

Summary

The capitulation of fascist Italy in September 1943 had a susceptible impact in Kosova. Along with the disarming of Italian military units the setting of German military units occurred having an impact on the political currents and flows of the war in general. Economic and educational circumstances suffered changes and new military units under the attention of Nazi Germany and independent nationalist ones were created. This happened as the borders of Kosova were threatened by the units of both National Liberation Army of Yugoslavia and National Liberation Army of Albania. At that time the operations of persecution, terror and reprisals increased, especially in areas where Chetnick and partisan forces could act. For this reason, defensive activities by the nationalist units were frequent too. Due to this Albanian-Serb armed clashes became more frequent. An important role at that time was played by the Second Prizren League, and its formation, Committee of Nationalist Youth for the Protection of Kosova. The hope was to have a just solution for Kosova at the Bujan Conference, which was soon denied by the Yugoslav political and military forces. Under such circumstances the activities by Albanian nationalists were further extended and spread covering almost all the ethnic territories. On the other hand, under the influence of the National army of Kosova, and especially of the National Army of Albania, armed partisan units grew as well both in Kosova and Macedonia, despite continued ignoring of Albanians by Yugoslav partisan forces. National Liberation Army forces of Yugoslavia and Albania were big and well armed, therefore Kosova and other Albanian ethnic areas were occupied again, although resistance by Albanians was considerable. During October and November 1944 in Kosova and other Albanian-inhabited territories massacres against Albanians increased having an impact on the further spreading of war against re-occupation and settling of the Communist system.

